



**TREGUESIT E REALIZIMIT TË
BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË**
VITI 2024



PËRMBAJTJA

	HYRJE	Fq.3
KAPITULLI I	Realizimi i të ardhurave të Bashkisë Tiranë për vitin 2024	Fq.5
KAPITULLI II	Realizimi i shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për 12 mujorin 2024	Fq.26
	Shpenzimet sipas programeve	Fq.27
	Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik	Fq.29
	Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fq.33
KAPITULLI III	Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve	Fq.40
KAPITULLI IV	Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për 12 mujorin e viteve 2020-2024	Fq.75

TREGUESIT E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR 12-MUJORIN 2024

HYRJE

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të 12 mujorit të vitit 2024 është bërë në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të NJQV”, udhëzimit plotësues nr.1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", VKB nr.125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024, (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Raporti bazohet në të dhënat për shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit. Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve.

Informacioni i përcjellë në këtë raportim është rezultat jo vetëm nga raportet e tërhequra nga SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) por dhe nga informacioni i përcjellë në mënyrë shkresore nga Drejtoritë e Bashkisë Tiranë dhe Institucionet e Varësisë të përfshira në këtë proces, informacioni i kuadruar dhe me Degën e Thesarit Tiranë.

Raporti i monitorimit paraqet monitorimin e zbatimit të buxhetit, performancën financiare të njësisë dhe krahasimin e treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet procesit të monitorimit evidentohet nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, ndjekja e qëllimit dhe objektivave të vendosura, si dhe sigurimi i informacionit do të shërbejë për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të zbatimit të buxhetit.

Bashkia Tiranë administron dhe menaxhon fondet sipas programeve të miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit 2024 si më poshtë:

Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01170: Gjendja civile

Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi – 03140: Shërbimet e policisë vendore

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile

Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbështetje për zhvillim ekonomik

Programi - 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi - 04240: Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi - 04570: Transporti publik

Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT

Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06190: Strehimi

Programi - 06210: Programet e Zhvillimit

Programi - 06260: Shërbimet Publike vendore

Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA

Programi - 08130: Sport dhe argëtim

Programi - 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Programi - 08230: Arti dhe Kultura

Funksioni 9 ARSIMI

Programi - 09120: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Programi - 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Programi - 09240: Arsimi profesional

Programi - 09450: Arsimi Universitar

Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE

Programi - 10910: Emergjenca Civile

Programi - 10430: Përkujdesja Sociale

Programi - 10661: Strehimi social

KAPITULLI I: REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2024

Të Ardhurat nga Taksat dhe Tarifave Vendore

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Tiranës është mbështetur mbi llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, në aktet ligjore të sistemit fiskal dhe në ecurinë e realizimit në vitet e mëparshme.

Për vitin 2024, plani i të ardhurave është miratuar në shumën 18,252,000,000 lekë. Në mbyllje të vitit 2024 rezulton se të ardhurat janë realizuar në shumën 26,618,979,546 lekë ose në masën 146 % ndaj planit, nga të cilat:

- të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 20,174,154,055 lekë
- të ardhura jotatimore janë realizuar në vlerën 6,444,825,491 lekë

Në lekë

Kategoria e të ardhurave	Plani 2024	Fakti 2024	%
Të ardhura tatimore	12,914,000,000	20,174,154,055	156%
Të ardhura jo tatimore	5,338,000,000	6,444,825,491	121%
Totali	18,252,000,000	26,618,979,546	146%

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore më kryesore të Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet një analize edhe për faktorët që kanë ndikuar në këto rezultate për vitin 2024, jepet në vijim.

Strukturat arkëtuese të të ardhurave për Bashkinë Tiranë, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Strukturat e Bashkisë
- Institucionet e varësisë
- Agjentët tatimorë

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, planin vjetor për vitin 2024 për 6,751,500,000 lekë e ka realizuar në masën 6,031,643,092 lekë ose 89%.

A. Taksa mbi ndërtesën

Të dhënat e realizimit 2024, për taksën mbi ndërtesat e subjekteve “familjarë” dhe subjekteve të biznesit paraqitet si më poshtë:

Në lekë


Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa mbi ndërtesën "Familjarë"	868,000,000	831,765,796	96%
Taksa mbi ndërtesën "Biznes"	2,935,000,000	2,359,721,652	80%

Gjatë vitit 2024 realizimi nga kjo taksë është më i lartë për të dy kategoritë biznese dhe familjarë krahasuar me vitet e tjera.

Në lekë

Taksa mbi ndërtesën	2021	2022	2023	2024
Familjarë	666,341,648	638,555,878	668,404,923	831,765,796
Biznesi	1,643,669,627	1,598,986,567	1,724,746,933	2,359,721,652
Totali	2,310,011,275	2,237,542,445	2,393,151,856	3,191,487,448

Grafikisht realizimi sipas viteve 2021-2024 paraqitet më poshtë:



Nga 1 prilli i vitit 2018 e në vazhdim ka filluar të mblidhet taksa e ndërtesës në bazë të ndryshimeve që i janë kryer ligjit mbi taksat vendore dhe në bazë të VKM nr 132 datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të aksës" dhe ndryshimeve që i janë kryer kësaj VKM-je me VKM numër 168 datë 27.3.2019 dhe VKM numër 144 datë 13.2.2020 dhe VKM 457 datë 26.07.2023.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2024 DPTTV zbatoi Vendimin me numër 35, datë 28.03.2024, të Këshillit Bashkiak Tiranë "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës"

Në zbatim të kësaj VKB-je, DPTTV arriti të mbledhë gjatë vitit 2024 vlerën 148,052,180 lekë për llogari të taksës së ndërtesës të vitit 2023.

Numri i njësive të pronës aktive të regjistruara për taksën e ndërtesës në lidhje me subjektet e biznesit jepet si më poshtë:

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Individë	30,374	30,792	31,373	32,161
Biznes i madh	4,750	5,024	5,388	5,916
Biznes i vogël	8,608	8,687	8,735	8,869
VIP	1,892	1,907	1,947	2,149
Të tjerë	2,624	2,588	2,569	2,531
Totali	48,248	48,998	50,012	51,626

Nga analiza e tabelës më lart del se numri i njësive të biznesit ka ardhur duke u rritur nga viti 2021 e në vazhdim. Rritja nga viti 2023 është me një numër 1,614 njësish prona biznesi dhe me një rritje 3% krahasuar me numrin e njësive të vitit 2024. Pjesën më të madhe të njësive aktive të vitit 2024 e zënë njësitë në pronësi të individëve.

Në tabelën e mëposhtme janë disa të dhëna për numrin e pronave të tarifuara, vlerën e tarifuar, pagesën e kryer në sistem deri më 31.12.2024 të ndara sipas klasifikimeve të aneksit 2 të VKM-së nr.132 datë 07.03.2018, për arkëtimet e kryera vetëm për vitin 2024.

Emërtimi	Njësi tarifuar	Sipërfaqe e tarifuar	Vlera e tarifuar	Pagesa deri 31.12.2024	Numri i likuiduesve	Sip. Likuiduese
Tregti e shërbime "a"	49,121	5,424,089	2,495,337,904	1,760,999,052	30,704	3,831,793
Bodrome parking "b"	258	130,709	40,969,900	32,835,582	219	109,847
Pika C	19	20,612	2,132,725	1,292,420	14	12,970
Prodhim, magazinë "ç"	1,946	1,866,232	280,397,654	254,722,538	1,707	1,706,300
Bujqesi "d"	46	22,863	1,968,995	1,793,665	33	20,408
Totali	51,390	7,464,505	2,820,807,178	2,051,643,258	32,677	5,681,317

Ndërkohë, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Bashkinë Tiranë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave nga kategoria "Familjarë", çdo muaj përgatit akt rakordimin mbi evidentimin e familjeve likuiduese të detyrimit dhe atyre përfituese të lehtësirave fiskale si dhe vlerën përkatëse që duhet t'i xhirojë Bashkisë Tiranë.

Problematikat në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë vazhdojnë të mbeten mos saktësimi i sipërfaqeve reale dhe faturimi i një pjese të abonentëve me sipërfaqe të prezumuar si dhe regjistrimi si abonentë për taksën e ndërtesës për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës Kanalizimin Tiranë sh.a. Kjo problematikë është duke u ndjekur për zgjidhje nëpërmjet evidentimit në terren.

B. Taksa mbi tokën bujqësore

Të dhënat e realizimit për vitin 2024 për taksën mbi tokën bujqësore nga të gjitha kategoritë disponuese të tokës, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa mbi tokën Bujqësore	34,500,000	27,847,714	81%

Fakti i diferencës së njësive aktive me ato likuiduese tregon për mosazhurnim të situatës në terren dhe pamundësinë e ndjekjes të njësive mospaguese për detyrimin e kësaj takse.

Njësitë aktive të tarifuara dhe që kanë likuiduar detyrimet e vitit 2024 janë si më poshtë:

Kategoria e tokës	Njësi Aktive të Tarifuara	Njësi Likuiduese	Sip. Aktive të tarifuara (në ha)	Sip. Likuiduese (në ha)
<i>Kategoria I</i>	3,902	2,166	1,059	577
<i>Kategoria II</i>	7	4	2	1
<i>Kategoria III</i>	1,817	821	1,037	415
<i>Kategoria IV</i>	1,913	902	985	431
<i>Kategoria V</i>	5,337	1,899	3,200	1,039
<i>Kategoria VI</i>	4,490	1,578	3,458	1,158
<i>Kategoria VII-X</i>	3,097	696	1,710	324
Totali	20,563	8,066	11,450	3,946

Problemet kryesore të hasura këto vitet e fundit në lidhje me këtë taksë janë:


- Mungon informacion i plotë për ngastrat e tokës bujqësore nga Njësitë Administrative;
- Regjistrimet e kryera nga inspektorët e terrenit në disa ish-komuna kanë mangësi për emrat, sipërfaqet dhe kategoritë.
- Ndryshime në llojin e tokës, raste kur me dokumenta figuron tokë bujqësore dhe në fakt është kthyer në truall.

Realizimi i taksës mbi tokën bujqësore është në rritje nga viti në vit por në vlerë shumë të vogël, më shumë me karakter rastësor të kryerjes së transaksioneve të shitblerjes.

Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Taksa mbi tokën bujqësore	22,183,650	23,431,924	24,596,313	27,847,714



C. Taksa mbi truallin

Taksa mbi truallin, ka të bëjë me truallin e përdorur për banesë dhe për biznes. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2024, janë realizuar në shumën 146,321,515 lekë, kundrejt planit 90,000,000 lekë, pra kemi një realizim prej 163%.

Të dhënat e realizimit për vitin 2024, për taksën mbi truallin, paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa e Truallit	90,000,000	146,321,515	163%

Struktura përgjegjëse për arkëtimin e taksës mbi truallin është DPTTV-ja në bashkëpunim me Njësitë Administrative. Të ardhurat nga kjo taksë kanë patur tendencë rritjeje shumë të mirë me realizim të lartë krahasuar me planifikimin duke arritur në 163%.

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë mbështetet tek evidentimi i njësive aktive dhe njësive likuiduese, të cilat vetëm për vitin 2024, paraqiten si më poshtë:

Lloji i truallit	Njësi Aktive të Tarifuar	Njësi Likuiduese	Sip. Aktive të Tarifuar	Sip. Likuiduese
Taksa mbi truallin - Truall për qëllime banimi	2,224	640	875,522	391,019
Taksa mbi truallin - Truall për qëllime biznesi	3,404	2,479	6,099,877	4,979,674
Totali	5,628	3,119	6,975,399	5,370,693

Problemet e konstatuara gjatë vitit 2024, janë:


- Mungesa e informacionit të plotë mbi pronësinë e truallit, në territorin e Bashkisë Tiranë.
- Mungesa e bashkëpunimit me struktura që disponojnë informacion mbi këtë formë pasurie por dhe pamundësia e azhurnimit të informacionit në terren.

Krahasimi i realizimit ndër vite është si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Taksa e Truallit	65,136,671	85,213,072	86,050,092	146,321,515

Grafikisht të dhënat e mësipërme të realizimit në vite:



D. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel është një detyrim mujor që evidentohet çdo fund-muaji nga pagesat e njësisive akomoduese.

Gjatë vitit 2024, janë evidentuar gjithsej 411 njësi hotelerie.

Për vitin 2024, janë realizuar të ardhura në shumën 164,778,526 lekë kundrejt planit për 150,000,000 lekë.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa e fjetjes në hotel	150,000,000	164,778,526	110%


Realizimin mbi planin e vitit 2024 është më i larti në katër vitet e fundit dhe me një rritje 21,770,100 lekë, në krahasim me vitin 2023, tregon se ky sektor i është rikthyer aktivitetit normal dhe se aktiviteti i hotelerisë pritet të ketë zhvillim në vitet në vazhdim duke marrë në konsideratë dhe rritjen e fluksit të turistëve që vizituan Tiranën në vitin 2024.

Realizimi i taksës së fjetjes në hotel për 4 vitet e fundit është paraqitur më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Taksa e fjetjes në Hotel	67,226,382	111,515,607	143,008,426	164,778,526

Grafikisht paraqitur më poshtë realizimi i taksës së fjetjes në hotel:



E. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës aplikohet mbi llojet e tabelave të mëposhtme:

- Tabela për qëllime identifikim/sinjalizimi vendoset jashtë territorit të aktivitetit të biznesi për të orientuar blerësit për vendndodhjen e biznesit, me sipërfaqe nën 2 m².
- Tabela për qëllime identifikimi deri 2 m², 2-10 m², 10-20 m², 20-40 m², mbi 40 m² janë tabelat e trupëzuara ose jo brenda territorit ku zhvillohet aktiviteti i biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)
- Tabelat për qëllime reklamimi e lëvizshme apo e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m².

Gjatë vitit 2024, janë evidentuar njësitë aktive të tarifuara dhe njësitë, të cilat kanë kryer likuidimin e detyrimit të taksës së tabelës për këtë vit, si më poshtë:

Emërtimi	Njesi aktive te tarifuara	Njesi likuiduese	Sipërfaqe aktive te tarifuara	Sipërfaqja likuiduese
<i>Për qëllime identifikimi mbi 2m</i>	1,354	1,334	6,573	6,175
<i>Reklamimi të thjeshtë</i>	77	45	583	540
<i>Elektronike</i>	41	38	406	398
Totali	1,472	1,417	7,5612	7,113

Gjatë vitit 2024 janë arkëtuar gjithsej 278,698,424 lekë ndaj planit prej 330,000,000 lekë.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Tabelë identifikuese/sinjalizuese</i>	250,000	203,773	82%
Tabelë reklamuese	329,750,000	278,494,651	84%
Totali	330,000,000	278,698,424	84%


Për vitin 2024, realizimi i të ardhurave nga kjo taksë, ka pësuar rritje në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rritje e të ardhurave të realizuara ka ardhur si pasojë e përdorimit më të lartë të reklamave në tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në 35 m².

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Tabelë</i>	80,618	73,269	594,009	203,773
<i>Reklamë</i>	260,033,125	296,113,058	275,124,192	278,494,651
Totali	260,113,743	296,186,327	275,718,201	278,698,424

Grafikisht realizimi i taksës së tabelës dhe reklamës në vite paraqitet më poshtë:



F. Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore është një taksë e përkohshme e miratuar në vitin 2015 për një periudhë 7 vjeçare dhe e ri-miratuar në vitin 2022 për një periudhë shtesë 3-vjeçare për të financuar investimet në infrastrukturën arsimore që përfshijnë ndërtime të reja, rikonstruksione, rehabilitime, shpronësime lidhur me këto ndërtime dhe pajisje e shkollave me mobilje dhe pajisje shkollore. Të ardhurat e mbledhura nga kjo taksë për vitin 2024 janë në masën 83% ndaj planit.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore	926,500,000	769,868,332	83%

Gjeni të paraqitur më në detaj, sipas dy nëndarjeve të mëdha për subjektet “Familjarë” dhe subjektet “Biznesi” realizimin e të ardhurave kundrejt planit për vitin 2024 si me poshtë:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Familjarë</i>	251,500,000	257,675,813	102%

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Biznesi</i>	675,000,000	512,192,519	76%

Në tabelë më poshtë pasqyrohen njësitë aktive të tarifuara, detyrimi respektiv vjetor, njësitë likuiduese dhe vlera e likuiduar vetëm për vitin 2024:

TPIA	Nj. të tarifuara	Detyrimi vjetor	Nj. likuiduese	Vlera e likuiduar
<i>Biznesi</i>	71,484	562,102,291	54,759	512,184,519

Krahas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore që ndjek dhe arkëton taksën e përkohshme nga infrastruktura arsimore nga kategoria “Biznes”, për kategorinë “Familjarë” rolin e agjentit tatimor e kryen Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a i cili faturon dhe arkëton detyrimin e kësaj takse.

Gjatë vitit 2024, nga ana e Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë sh.a është arkëtuar në favor të Bashkisë Tiranë vlera prej 257,675,813 lekë.

Realizimi ndër vite i taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Taksa e përkohshme për infrastrukturën Arsimore	2021	2022	2023	2024
<i>Familjarë</i>	322,772,232	310,870,137	235,285,996	257,675,813
<i>Biznesi</i>	434,195,046	448,649,508	454,324,472	512,192,519
Totali	756,967,278	759,519,645	689,610,468	769,868,332

G. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, bën zbardhjen e lejes kundrejt arkëtimit të vlerës së taksës në masën e llogaritur. Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2024 janë realizuar në masën 226% kundrejt planit të miratuar.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,360,000,000	14,344,356,588	226%

Viti 2024 rezulton përsëri vit i suksesshëm për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, duke arritur vlerën më të lartë të arkëtuar ndër vite. Në këtë vlerë realizimi ka ndikuar edhe miratimi i VKM-se 457 datë 26.07.2023.


Realizimi i kësaj takse ndër vite paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	7,438,141,907	7,414,035,966	9,395,507,091	14,344,356,588

Grafikisht realizimi ndër vite paraqitet si më poshtë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja



TARIFAT

H. Tarifa e Pastrimit

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Nga të dhënat bazuar në arkëtimet shihet se të ardhurat janë realizuar në masën 99% për subjektet e biznesit.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Biznesi"	1,787,000,000	1,761,338,881	99%

Tarifa e pastrimit për kategorinë “Familjarë”, për vitin 2024 është realizuar në masën 143%, realizim me trend pozitiv krahasuar me vitin 2023.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024 janë arkëtuar rregullisht detyrimet për tarifën e pastrimit nëpërmjet faturës së ujit. Numri mesatar i familjeve likujduese 142,252 familje.

Në lekë


Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Tarifa e pastrimit nga subjektet "Familjarë"	827,500,000	1,018,844,442	123%

Në lidhje me subjektet “Familjarë” realizimi i këtij viti është në nivel më të lartë krahasuar me realizimin në vitet e mëparshme dhe me planin për vitin 2024.

Në lekë

Tarifa e pastrimit	2021	2022	2023	2024
<i>Familjarë</i>	790,364,210	761,759,858	712,146,029	1,018,844,442
<i>Biznesi</i>	1,448,405,768	1,538,436,158	1,520,073,424	1,761,338,881
Totali	2,238,769,978	2,300,196,016	2,232,219,453	2,780,183,323

Grafikisht të ardhurat e realizuara për katër vitet e fundit paraqiten si më poshtë:



I. Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m² e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj.
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.

Taksa për zënien e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj faturohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me njësitë administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë, për çdo rast të përdorimit të hapësirave publike kundrejt një tarife mujore sipas ndarjes zonale të miratuar me nivele që vijnë duke u ulur me largimin nga qendra, nga 1,500 leke/m²/muaj deri në 200 leke/m²/muaj.

Të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirave publike për vitin 2024 janë në vlerën 338,247,678 lekë.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella</i>	329,000,000	288,247,678	88%
<i>Tarifa për zënien e hapësirës publike</i>	21,000,000	50,000,000	238%
Totali	350,000,000	338,247,678	97%


Pjesa më e madhe e të ardhurave të gjeneruara nga tarifa për zënien e hapësirës publike është përqëndruar tek Tarifa për zënien e hapësirës publike me platforma, kangjella etj.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike nga viti 2021 deri në vitin 2024 paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Tarifa për zënien e hapësirave publike</i>	276,055,695	346,830,117	372,234,181	338,247,678

Grafikisht të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e zënies së hapësirës publike në këto vite paraqiten si më poshtë:



Probleme të konstatuara, janë:

- Mosdeklarimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim nga ana e subjekteve;
- Jo azhornimi i saktë i sipërfaqeve në përdorim për mosangazhimin e duhur nga strukturat e ngarkuara;

J. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime.

Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime paguhet në masën 1% të vlerës së investimit për aplikim për leje ndërtimi dhe 10 lekë për m² për sipërfaqe zhvillimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Vlera e planifikuar për t'u arkëtuar gjatë vitit 2024 ishte 450,000,000 lekë, e lidhur me planifikimin për taksën së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, e cila u realizua në masën 98% kundrejt planifikimit me një realizim faktik në vlerën 441,893,377 lekë.

Në lekë


Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime</i>	450,000,000	441,893,377	98%

Realizimi i kësaj tarife ndër vite paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime</i>	664,327,871	324,432,169	981,557,418	441,893,377

Grafikisht ecuria e kësaj tarife për vitet 2021-2024 paraqitet si më poshtë:



TIRANA PARKING

K. Tarifa e parkimit.

Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Tiranës për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, vendqëndrime të rezervuara dhe vendqëndrime për taksitë e liçensuara.

Për vitin 2024, arkëtimet nga tarifat e parkimit sipas natyrës së tarifimit të parkimit krahasuar me planin vjetor, janë realizuar si më poshtë:

Në lekë

Tarifa e parkimit të automjeteve	Plan 2024	Fakt 2024	%
Parkim me kontratë	140,000,000	177,813,765	127%
Parkim me bileta	483,000,000	325,960,471	67%
Në sheshe	279,698,000	282,791,078	101%
SMS- Parking	173,302,000	82,928,040	48%
Totali	623,000,000	586,702,276	94%

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2024 ka qënë më i lartë se vitet e tjera për shkak të përdorimit më të madh nga ana e individëve të parkimit me kontratë dhe përdorimit më masiv të shesheve parkuese.

Realizim të ulët ka pasur parkimi me SMS me një përqindje realizimi 48%.

Arsyet për këtë realizim janë:

- Ulja e vendeve të parkimit dhe shtimi i vendeve për taksit kanë reduktuar numrin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake për parkimet në vizat blu.
- Ulje e vendparkimeve me pagesë nga 2907 në vitin 2023 në 2726 në vitin 2024 për shkak të rikualifikimit urban.

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Tarifa e parkimit	498,689,407	530,625,181	566,360,290	586,702,276

Grafikisht realizimi i tarifës së parkimit për vitet 2021-2024 paraqitet si më poshtë:



INSTITUCIONE TË TJERA

DREJTORIA TATIMORE RAJONALE TIRANË

L. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Duke nisur nga viti 2022 bizneset që realizojnë gjatë vitit një qarkullim deri në 14,000,000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, do ta kenë shkallën tatimore mbi fitimin është 0 (zero).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse vendore deri në momentin e aplikimit të saj është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me të cilën Sektori i Agjenteve tatimorë pranë DPTTV, çdo muaj kryen rakordimin e të ardhurave të realizuara.

Për vitin 2024 nuk u parashikua plan për të ardhurat nga ky tatim dhe realizimi ka lidhje me pagesën e detyrimeve të prapambetura të viteve të mëparshme.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga ky tatim për vitin 2024, paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël</i>	0	29,428,991	

Sipas akt rakordimeve rezulton se nga totali i arkëtimeve në shumën 29,428,991 lekë tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 1% që i kalon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është në shumën 29,428,991 lekë, vlerë e cila ekzekutohet vetëm pas miratimit me vendim të Këshillit Bashkiak, si përdorim të ardhurash.

Ecuria ndër vite e këtij tatimi paraqitet si vijon:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV</i>	230,422,386	29,022,177	27,213,918	29,428,991

AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS

M. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Nga rakordimet e bëra me këtë Agjenci nga Sektori i Agjentëve Tatimorë, realizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2024, është 83% e planit vjetor siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme:

Në lekë


Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
<i>Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme</i>	480,000,000	399,078,435	83%

Ecuria për vitet 2021-2024 e kësaj takse paraqitet si vijon:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme</i>	445,977,729	538,304,919	378,211,917	399,078,435

Grafikisht realizimi i kësaj takse paraqitet si më poshtë:



DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR

N. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Agjenti tatimor i kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor e cila çdo muaj krahas kontrollit teknik, realizon edhe arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura nga e cila i kalon Bashkisë 18% të shumës së arkëtuar, pasi ka zbritur 5%, si komision të përfituar si agjent tatimor.

Sipas akt rakordimeve mujore të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Vendore dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, rezulton se krahas të ardhurave të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura është evidentuar dhe numri i mjeteve që kanë likujduar këtë taksë, si më poshtë:

Muaji	Nr. mjeteve	Vlera e arkëtuar dhe kaluar për Bashkinë Tiranë
Dhjetor 2023	25,172	93,400,970
Janar	13,242	45,748,924
Shkurt	12,327	39,251,622
Mars	11,310	32,908,710
Prill	12,934	34,803,273
Maj	16,610	43,233,289
Qershor	16,502	46,535,367
Korrik	20,098	57,763,765
Gusht	16,954	48,624,541
Shtator	14,398	41,696,429
Tetor	16,374	45,754,839
Nentor	13,676	40,142,407
Totali	189,597	569,864,136

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2024 është në masën 116%, ashtu siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	490,000,000	569,864,137	116%

Realizimi i këtij viti rezulton më i larti nga vitet e kaluara me një rritje numri mjeteve që kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura.

Ecuria ndër vite e kësaj takse paraqitet si vijon:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	466,305,347	490,556,445	513,485,562	569,864,137

Grafikisht realizimi i kësaj taksë paraqitet si më poshtë:



TË ARDHURA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE DHE KONVIKTET

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila llogaritet nga tarifa ditore për ushqimin dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë muajit.

Realizimi i arkëtimit të këtyre pagesave, për vitin 2024, është si më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	%
Të ardhurat nga Kopshtet	268,684,008	192,932,515	72%
Të ardhurat nga Çerdhet	126,315,992	118,006,840	93%
Të ardhurat nga Konviktet	7,800,000	8,354,002	107%

Investimet e kryera nga Bashkia Tiranë në drejtim të përmirësimit të kushteve por dhe në rritjen e kapaciteteve në kopshtet e çerdhet e Tiranës janë reflektuar edhe në rritjen e ndjeshme të frekuentimit të fëmijëve në këto institucione për pasojë edhe në rritjen e të ardhurave prej tyre.

Realizimi i të ardhurave nga Kopshtet për vitin 2024 është në masën 72% përkundrejt planit të këtij viti.

Në këtë realizim kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

- Ulja e frekuentimeve si pasojë e frekuentimit të kopshteve private
- Ulja e frekuentimit si pasojë e emigrimit të familjeve
- Përdorimi i parapagimeve për frekuentimet e muajve të fundit para largimit.

Krahasuar me vitet e mëparshme, viti 2024 ka pasur një rritje të të ardhurave të mbledhura nga këto aktivitete si pasojë e rikthimit në normalitet të frekuentimit të këtyre strukturave.

Në lidhje me të ardhurat nga konviktet rënia ka ardhur si pasojë e uljes së frekuentimit të ditë-ngrënieve nga studentët, rregullimeve tarifore dhe reduktimit të numrit të studentëve si pasojë tkurrjen e popullsisë.

Ecuria ndër vite e këtyre të ardhurave paraqitet si vijon:

Në lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	2024
<i>Të ardhura nga Kopshtet</i>	138,846,520	156,159,803	170,974,027	192,932,515
<i>Të ardhura nga Çerdhet</i>	78,146,033	85,353,791	99,330,465	118,006,840
<i>Të ardhurat nga Konviktet</i>	4,777,298	9,745,085	11,548,175	8,354,002

KAPITULLI II

REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË PËR VITIN 2024

Buxheti fillestar vjetor i vitit 2024 ka qenë **33,439,539,639** lekë. Buxheti i Bashkisë Tiranë, pas zbatimit të VKB Nr. 36, datë 28.03.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125, datë 22.12.2023, të Këshillit bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, VKB Nr. 47 datë 30.04.2024 “Për shpërblim financiar të Klubit të Futbollit “Partizani” sh.a, si rezultat i fitimit të vendit të parë, në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore, për sezonin 2022-2023”, VKB Nr. 57 datë 27.06.2024 “Për mbështetjen e studentëve shqipëtarë që janë pranuar për të studiuar pranë Kolegjit të Europës në Tiranë”, VKB Nr. 69 datë 27.06.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, VKB Nr.76 datë 22.07.2024 “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “TEDA Tiranë” shpk, si person juridik në pronësi të BT”, VKB Nr. 77, datë 22.07.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125 dt 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të BT për vitin 2024” të ndryshuar mbi ndryshimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Tiranë, VKB Nr.108, datë 08.10.2024 “Për riorganizimin e Muzeut Vendor “Shtëpia Studio Kadare”, VKB Nr. 116, datë 08.10.2024 VKB për miratimin e shtesës së fondeve të akorduara nga qeverisja qendrore si rezultat i rritjes së pagave viti 2024 dhe përfshirjes në buxhetin e vitit 2024 të fondeve të akorduara sipas marrëveshjes për programin dypalësh të ndihmës e të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për zbatimin e projektit “Ndërtim Godina 23”, shkon në vlerën **50,707,604,066** lekë.

Ndryshimet në buxhet referuar planit fillestar dhe atij të ndryshuar në fund të vitit ndarë sipas burimeve të financimit jepen të detajuara në vazhdim:

- Fondet e trashëguara nga të ardhurat e Bashkisë nga viti 2023 për vitin 2024, në shumën 5,348,094,549 lekë.
- Fondet e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme nga viti 2023 për vitin 2024, në shumën 1,300,359,845 lekë.
- Fondet e trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar (fonde rindërtimi) nga viti 2023 për vitin 2024, në shumën 2,298,578,857 lekë.
- Fondet e trashëguara nga fondet e donatorëve nga viti 2023 për vitin 2024, në shumën 41,695,258 lekë.
- Fonde financime të huaja 2024 në vlerën 275,000,000 lekë
- Fonde të akorduara rindërtimi viti 2024 në shumën 3,334,397,852 lekë.
- Fonde të akorduara nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme viti 2024 si rezultat i rritjes së pagave në vlerën 94,199,789 lekë.
- Fonde të akorduara nga donatori 2024 në vlerën 11,924,882 lekë.
- Fonde të akorduara si fonde të kushtëzuara nga qeveria në vlerën 4,563,813,395 lekë

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Ndryshimet +/-	Plan fund viti 2024	%
Shpenzime personeli	9,074,742,614	677,131,218	9,751,873,832	7%
Shpenzime të tjera operative	10,336,038,579	4,867,580,617	15,203,619,196	32%
Shpenzime kapitale	14,028,758,446	1,251,562,488	15,280,320,934	8%
Totali	33,439,539,639	6,796,274,323	40,235,813,962	17%

*burim financimi nga te ardhurat, transferta e pakushtezuar sektoriale, donatorë

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Ndryshimet +/-	Plan fund viti 2024	%
Shpenzime personeli				0%
Shpenzime të tjera operative		322,552,489	322,552,489	100%
Shpenzime kapitale		5,310,424,220	5,310,424,220	100%
Totali	-	5,632,976,709	5,632,976,709	100%

*burim financimi fondet e rindertimit

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Ndryshimet +/-	Plan fund viti 2024	%
Shpenzime personeli		81,877,000	81,877,000	0%
Shpenzime të tjera operative		3,339,273,411	3,339,273,411	100%
Shpenzime kapitale		1,417,662,984	1,417,662,984	100%
Totali	-	4,838,813,395	4,838,813,395	100%

*burim financimi fondet e kushtezuara dhe financime te huaja

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Ndryshimet +/-	Plan fund viti 2024	%
Shpenzime personeli	9,074,742,614	759,008,218	9,833,750,832	8%
Shpenzime të tjera operative	10,336,038,579	8,529,406,517	18,865,445,096	45%
Shpenzime kapitale	14,028,758,446	7,979,649,692	22,008,408,138	36%
Totali	33,439,539,639	17,268,064,427	50,707,604,066	34%

*nga te gjithe burimet e financimit


4.1 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:

	Emërtimi	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	% ndaj planit vjetor	struktura/plani vjetor
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	4,617,188,894	5,355,049,979	4,150,620,230	78%	11%
01170	Gjendja Civile		81,877,000	77,871,658	95%	0%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	762,045,000	922,403,120	737,941,427	80%	2%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	348,386,375	1,353,628,744	727,408,571	54%	3%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	748,160,242	959,289,738	537,396,987	56%	2%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	429,776,666	410,368,977	246,463,993	60%	1%
04240	Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit	23,851,233	66,693,394	24,408,431	37%	0%
04260	Administrimi i Pjjeve & Kullotave	11,794,754	12,665,994	11,472,000	91%	0%
04520	Rrjeti Rrugor Rural	4,718,218,203	5,937,893,570	3,974,986,348	67%	12%
04570	Transporti Publik	886,708,040	1,017,421,597	570,873,217	56%	2%
05100	Menaxhim i Mbetjeve	2,916,889,090	3,338,281,773	2,755,245,783	83%	7%
06140	Planifikim Urban Vendor	1,624,906,359	2,213,880,990	479,820,399	22%	4%
06190	Strehimi		23,542,675	19,093,265	81%	0%
06210	Programet e Zhvillimit	12,154,259	4,778,799,474	2,406,025,816	50%	9%
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane				0%	0%
06260	Shërbimet Publike Vendore	4,979,909,079	5,197,762,887	2,933,015,453	56%	10%
08130	Sport dhe Argëtim	551,330,000	744,595,667	683,432,570	92%	1%
08220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	982,611,572	1,593,571,856	1,316,349,822	83%	3%
08230	Arti dhe Kultura		470,312,000	367,447,437	78%	1%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	3,684,455,451	5,102,428,431	3,647,405,772	71%	10%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	2,196,350,464	2,661,756,862	2,105,751,153	79%	5%
09240	Arsimi Profesional		31,840,920	31,520,304	99%	0%
09450	Arsimi Universitar		268,563,765	268,563,765	100%	1%
10430	Përkujdesje Sociale	391,775,740	3,499,753,720	3,351,779,393	96%	7%
10661	Strehimi Social	3,271,728,660	3,604,498,529	675,090,627	19%	7%
10910	Emergjencë Civile		151,373,695	94,424,263	62%	0%
04910	Fondi Rezervë	141,299,558	769,348,709		0%	2%
04940	Fondi i Kontigjencës	140,000,000	140,000,000		0%	0%
	TOTAL	33,439,539,639	50,707,604,066	32,194,408,684	63%	100%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, TVSH Detyrime, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin, Financimet e Huaja, Transfertën e Kushtëzuar

- **Programi Shërbimet e Policisë Vendore** i cili përbën 2% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 80% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Rrjeti Rrugor** i cili përbën 12% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 67% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Planifikimi Urban Vendor** i cili përbën 4% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 22% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Shërbimet Publike** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 56% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor** i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 71% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Arsimi i mesëm i përgjithshëm** i cili përbën 5% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 79% të 12-mujorit 2024.
- **Programi Përkujdesje Sociale** i cili përbën 7% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 96% të 12-mujorit 2024.



4.2 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Në total, Bashkia Tiranë ka një realizim prej 63% të planit 12-mujor 2024. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik, realizimi nga të gjitha burimet e financimit paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 87%,
- Shpenzimet operative me 77% dhe
- Shpenzimet kapitale me 41%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2024	Plani 12M 2024	Në lekë	
			Fakti 12M 2024	Realizimi në 12M %
<i>Shpenzime personeli</i>	9,833,750,832	9,833,750,832	8,561,300,837	87%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	18,865,445,096	18,865,445,096	14,604,298,954	77%
<i>Shpenzime kapitale</i>	22,008,408,138	22,008,408,138	9,028,808,893	41%
<i>Totali</i>	50,707,604,066	50,707,604,066	32,194,408,684	63%



4.3 Tabela e raportit të shpenzimeve të personelit

Fondi i Shpenzimeve të personelit për vitin 2024 është në vlerën 9,833,750,832 lekë dhe për vitin 2024 realizimi është në masën 87 % të planit vjetor.

Sikundër vihet re edhe në pasqyrën e mëposhtme numri faktik i punonjësve është 8,714 punonjës.

Më poshtë gjeni të dhëna të pasqyruara në mënyrë tabelare:

Emërtimi	Nr i punonjesve Plan 2024	Nr i punonjeseve Fakt 2024	Buxhet 2024	Fakt 2024	% Realizimi
Aparati Bashkise	2,492	2,404	3,432,196,648	3,017,643,866	88%
Agjencia e Mbrojtjes se Konsumatorit	188	183	218,481,000	199,257,636	91%
Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	420	393	409,551,000	363,123,928	89%
Agjencia per Administrimin e Tregjeve	48	48	53,340,000	53,112,861	100%
Drejtoria e Pergjithshme e Pastrim Gjelberimit	600	562	499,668,000	464,223,663	93%
Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndricimit	585	582	528,023,000	523,271,207	99%
Drejtoria e Pergjithshme e Objekteve Publike	1,074	1,072	904,022,085	775,271,179	86%
Drejtoria e Konvikteve	113	113	133,161,131	101,512,936	76%
Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendor	260	250	317,150,000	300,820,627	95%
Klubi Sportiv Tirana	47	44	51,642,000	45,103,805	87%
Agjencia Sherbimeve Funerale	185	183	143,975,000	130,659,538	91%
Drejtoria e Pergjithshme e Kopshteve dhe Cerdheve	2,223	2,078	2,249,563,095	1,777,541,436	79%
Qendra Komunitare Shkoze	28	28	29,497,000	29,069,716	99%
Qendra Kulturore Tirana	60	58	60,904,000	58,400,445	96%
Qendra Sociale Multidisiplinare	27	27	29,497,000	24,502,477	83%
Qendra Rinore TEN	21	21	21,792,000	21,545,205	99%
Qendra "Te qendrojme se bashku"	28	28	30,170,000	28,292,471	94%
Shkolla "Luigj Gurakuqi"	15	15	17,049,779	12,701,492	74%
Tirana Parking	158	158	172,796,000	158,337,835	92%
Qendra Sociale "Strehëza"	14	14	16,854,000	13,315,793	79%
Qendra Komunitare "Gonxhe Bojaxhi"	27	27	28,475,000	26,017,586	91%
Klubi Shumësportesh "Partizani"	13	13	16,626,353	14,164,580	85%
Klubi Sportiv "Studenti"	18	18	20,443,741	18,462,633	90%
Muzeu Vendor "Shtepia Studio Kadare-Agolli"	10	6	7,557,000	7,410,341	98%
Muzeu Vendor Shtepia Studio Agolli	6	-	6,882,000	3,531,432	51%
Qendra e Restaurimit dhe Realizimit te Veprave te Artit	12	12	10,613,000	10,535,968	99%
Qendra Komunitare e Terrenit	37	35	40,391,000	32,243,369	80%
Agjencia e Rinise	15	15	17,588,000	15,542,268	88%
Galeria e Artit Tirana	19	17	22,166,000	20,042,200	90%
IMT	189	189	222,332,000	211,421,067	95%
Agjencia Industrise Rekreative	31	31	31,244,000	28,898,028	92%
Qendra Komunitare "Per persona me aftesi te kufizuar"	28	25	27,846,000	23,190,019	83%
Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik	68	65	62,254,000	52,133,230	84%
TOTAL	9,059	8,714	9,833,750,832	8,561,300,837	87%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale, Transfertën e Kushtëzuar

Gjatë vitit 2024, me qëllim rritjen e cilësisë dhe menaxhimit sa më me efikasitet të burimeve njerëzore si dhe transparencën e administratës ndaj publikut, për t'i shërbyer sa më mirë këtij të fundit dhe për përfitim të interesave maksimale, për institucionin e Bashkisë së Tiranës u propozuan ndryshime në numrin e punonjësve të Bashkisë Tiranë, miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendimin nr.77 datë 22.07.2024 për shtesë në numrin total të punonjësve të Bashkisë me 395 punonjës.

Gjatë këtij viti, ky ka qenë i vetmi vendim Këshilli Bashkiak ku ka patur ndryshime në numrin e punonjësve të Bashkisë Tiranë

4.4 Tabela e raportit të shpenzimeve operative sipas programeve

Në lekë

	Emërtimi	Plan 12M 2024	Fakti 12M 2024	%
	<i>Emërtimi</i>			
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	2,154,470,993	1,577,965,780	73%
03140	Shërbimet e Policise Vendore	118,531,000	24,557,001	21%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	872,110,106	465,256,273	53%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	195,353,858	110,933,492	57%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	101,076,058	46,642,357	46%
04240	Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit	24,141,902	23,941,902	99%
04260	Administrimi i Pyjeve & Kullotave	12,089,994	11,472,000	95%
04520	Rrjeti Rrugor Rural	1,560,127,939	1,434,884,182	92%
04570	Transporti Publik	541,418,040	388,133,157	72%
05100	Menaxhim i Mbetjeve	3,335,901,081	2,755,245,783	83%
06140	Planifikim Urban Vendor	306,131,400	155,551,922	51%
06190	Strehimi	23,542,675	19,093,265	81%
06260	Shërbimet Publike Vendore	984,942,827	715,290,330	73%
08130	Sport dhe Argëtim	638,125,573	589,991,284	92%
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	1,207,653,492	1,088,649,205	90%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	991,590,528	738,990,320	75%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	731,125,358	651,105,466	89%
09240	Arsimi Profesional	31,840,920	31,520,304	99%
10430	Përkujdesje Sociale	3,286,446,580	3,170,133,539	96%
10661	Strehimi Social	741,889,587	542,778,157	73%
10910	Emergjencë Civile	97,586,476	62,163,235	64%
04910	Fondi Rezervë	769,348,709	-	0%
04940	Fondi i Kontigjencës	140,000,000		0%
	TOTAL	18,865,445,096	14,604,298,954	77%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin, Transfertën e Kushtëzuar

Fondi i Shpenzimeve operative për vitin 2024 është në vlerën 14,604,298,954 lekë dhe për vitin 2024 realizimi është në masën 77 % të planit vjetor.

Programet me realizimin më të lartë të shpenzimeve si Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit, Administrimi i Pyjeve & Kullotave, Rrjeti Rrugor Rural, Sport dhe Argëtim, Trashëgimia Kulturore, Arsimi Profesional dhe Përkujdesja Sociale janë programe që janë mbuluar me 64% nga burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë, 18% nga transfertë e kushtëzuar dhe 17% nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale.

4.5 Tabela e raportit të shpenzimeve kapitale sipas programeve

Në lekë

	Emërtimi	Plan 12M 2024	Fakti 12M 2024	%
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	470,991,476	211,884,715	45%
03140	Shërbimet e Policise Vendore	107,758,120	17,802,120	17%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	239,750,500	77,911,504	32%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	710,595,880	373,350,634	53%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	90,811,919	564,000	1%
04240	Menaxhim I Infrastrukturës se Ujitjes & Kullimit	42,311,492	466,529	1%
04520	Rrjeti Rrugor Rural	3,849,982,631	2,016,830,959	52%
04570	Transporti Publik	303,207,557	24,402,225	8%
05100	Menaxhim I Mbetjeve	2,380,692		0%
06140	Planifikim Urban Vendor	1,685,417,590	112,847,410	7%
06210	Programet e Zhvillimit	4,778,799,474	2,406,025,816	50%
06260	Shërbimet Publike Vendore	3,160,202,060	1,259,717,994	40%
08130	Sport dhe Argëtim	170,000	168,000	99%
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	162,506,364	25,203,768	16%
08230	Arti dhe Kultura	470,312,000	367,447,437	78%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	1,844,225,029	1,118,172,524	61%
09230	Arsimi I mesëm I përgjithshëm	893,448,288	577,861,572	65%
09450	Arsimi Universitar	268,563,765	268,563,765	100%
10430	Përkujdesje Sociale	10,577,140	5,014,423	47%
10661	Strehimi Social	2,862,608,942	132,312,470	5%
10910	Emergjencia Civile	53,787,219	32,261,028	60%
	TOTAL	22,008,408,138	9,028,808,893	41%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, TVSH Detyrime, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin, Financimet e Huaja, Transfertën e Kushtëzuar

Fondi i Shpenzimeve kapitale për vitin 2024 është në vlerën 9,028,808,893 lekë dhe për vitin 2024 realizimi është në masën 41 % të planit vjetor.


Programet me realizimin më të lart janë “Arti dhe Kultura” i cili përfshin fondet e kushtëzuara të akorduara nga Ministria e Kulturës në lidhje me projektin “Godina e Teatrit Tiranë”, programi “Arsimi Bazë përfshirë arsimin parashkollor” si dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” ku përveç objekteve që financohen nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë përfshihen dhe projekte që bashkëfinancohen nga Qeveria si PPP-të e shkollave apo Projekti i Kampusit Tiranë.

4.6 Tabela e raportit sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 12-mujor 2024, paraqiten si më poshtë:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %	struktura vjetore
Të ardhura BT	28,252,000,000	33,600,094,549	20,052,299,940	60%	66%
Transferta e Pakushtëzuar +Sektoriale	5,179,857,935	6,574,417,569	5,079,893,672	77%	13%
Transferta e Pakushtëzuar Rindërtimi		5,632,976,709	2,690,278,733	48%	11%
Transferta e Kushtëzuar		4,563,813,395	4,350,606,969	95%	9%
Donacione	7,681,704	61,301,844	21,329,370	35%	0%
Financime të huaja,Grante 02		275,000,000		0%	1%
Totali	33,439,539,639	50,707,604,066	32,194,408,684	63%	100%

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 12-mujor 2024 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 33,600,094,549 lekë e cila përbën 66% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 13% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindërtimi zënë 11% të burimeve të financimit të planifikuara. Fondet e Kushtëzuara zënë 9% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:




4.7 Tabela e raportit të donacioneve

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e burimit Donator në bazë programesh:

Në lekë

	Emërtimi	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	% ndaj planit vjetor	struktura/plani vjetor
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim		26,824,622	3,500,000	13%	44%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile		555,000		0%	1%
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik		16,411,827	11,765,513	72%	27%
04520	Rrjeti rrugor		2,800,000		0%	5%
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore		457		0%	0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	7,681,704	14,709,938	6,063,857	41%	24%
	TOTAL	7,681,704	61,301,844	21,329,370	35%	100%

Gjatë vitit 2024 realizim në fondin e donatorëve kanë patur dy marrëveshjet e bashkëpunimit mes Bashkisë Tiranë, BKT-së dhe Mediterranea Shpk për hapjen e çerdhes për fëmijët e stafit të këtyre shoqërive, në kuadër të vënies në zbatim të projektit “Çerdhe dhe kopësht pranë vendit të punës”. Këto marrëveshje vijojnë dhe janë pjesë e buxhetit të vitit 2024 pasi të dy shoqëritë depozitojnë rregullisht donacionet në llogari të Bashkisë Tiranë në mënyrë që të vijohet normalisht me pagesat e shpenzimeve të personelit. Në programin e mbështetjes për zhvillim ekonomik realizim gjatë vitit 2024 ka patur dhe fondi për “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i tregut agrorshqimor të Tiranës” fond i akorduar nga AZHBR si shpallje fituesi i projektit nga ana e Bashkisë Tiranë.



4.8 Tabela e raportit të fondeve të kushtëzuara

Në tabelën më poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe për Bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për vitin 2024. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Ndihmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Subvencionim i qerave për familjet e prekura nga tërmeti
- Subvencionim i qerave për familjet e prekura nga shpronësimi
- Per permiresimin e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine e Tiranes
- Bursa
- Transferime
- Kampusin e Tiranes
- Godina e Teatrit
- Fond për mbrojtjen civile në zbatim të VKM 414 dt.08.07.2021

Sipas produkteve dhe llogarive ekonomike fondet e deleguara paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Përshkrimi	Llogaria Ekonomike	Plani 2024	Faktik 12 Mujori	Realizimi ne %
Paga	600	70,125,000	66,728,326	95%
Sig.Shoqerore	601	11,752,000	11,143,332	95%
Subvencionim i qerase per banore te shpronesuar nga Unaza e Madhe Tirane	606	23,542,675	19,093,265	81%
Godina e teatrit Tirane kod projekti 18AE716	231	470,312,000	367,447,437	78%
Per permiresimin e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine e Tiranës "Per projektimin,financimin,ndertimin,mobilimin,mirembajtjen,mbikqyrjen dhe kolaudimin e pese objekteve arsimore ne Zonen Tirana 1" (18BC893)	231	211,254,013	211,254,013	100%
Per permiresimin e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine e Tiranës "Per projektimin,financimin,ndertimin,mobilimin,mirembajtjen,mbikqyrjen dhe kolaudimin e pese objekteve arsimore ne Zonen Tiran 4 (22AC516)	231	138,745,987	138,367,858	100%
Femije ne nevoje qe perfitojne sherbim arsimor cilesor (Bursa)	602	62,078,040	61,172,556	99%
Femije ne nevoje qe perfitojne sherbim arsimor cilesor (Bursa)	606	131,760		0%
Nxenes qe regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesem dhe te larte ne institucione(Bursa)	602	23,434,200	23,341,758	100%
Bursa	606	31,840,920	31,520,304	99%
Fond studim projektim per Kampusin e Tiranës	231	268,563,765	268,563,765	100%
Ndihma Ekonomike (91307AA)	606	251,146,000	250,937,631	100%
PAK (91307AB)	606	2,832,628,000	2,792,514,281	99%
Vendimet e gjykatës për indeksimin e pagesës PAK (91307AL)	606	10,092,000	9,786,439	97%
Fond Social	606	6,793,340	4,311,741	63%
Shpenzime per marrjen e masave parandaluese mbrojtese rehabilituese ne objekte te ndryshme	604	97,586,476	62,163,235	64%
Rehabilitim / Nderhyrje emergjente ne infrastrukture	231	53,787,219	32,261,028	60%
TOTAL		4,563,813,395	4,350,606,969	95%

Fondet e kushtëzuara që i akordohen Bashkisë Tiranë për financimin e funksioneve të deleguara nga Qeverisja Qëndrore, fonde të cilat nuk trashëgohen në vitin pasardhës janë realizuar në masën 96 %.

4.9 Tabela e raportit të fondeve të rindërtimit:

Programet e rindërtimit të nisur në vitin 2020 kanë vijuar edhe gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, me vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 36, datë 28.03.2024 u miratua shtesa në buxhet e fondeve të trashëguara nga rindërtimi nga viti 2023 në shumën 2,298,578,857 lekë ndërsa me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 69, datë 27.06.2024, u miratua në buxhetin e vitit 2024 shtesa e fondeve të rindërtimit të vitit 2024 në vlerën 3,334,397,852 lekë.

Shtesat e fondeve kryesisht u bënë për VKM-të e objekteve arsimore, rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesa publike në zonat e reja për zhvillim në Njësitë 4 dhe 8, Zona 5 Maji Kombinat, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, rificimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë.

Duke qenë se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk na u miratuan fonde për DS-të Bashkia e Tiranës edhe përgjatë vitit 2024 ashtu si gjatë vitit 2023, përfshiu një pjesë të detyrimeve për DS1,DS3, DS4 dhe DS5 ti përballojë nga të fondet e veta të Bashkisë Tiranë, me një plan prej 422,346,363 lekë dhe realizim prej 415,513,828 ose 98%.

Në pasqyrën më poshtë po paraqesim një informacion mbi fondet e rindërtimit sipas VKM-ve të akorduara që në vitin 2020 për Bashkinë e Tiranës dhe realizimin e tyre, informacion i cili është pjesë dhe e akt-rakordimit të mbajtur me Degën e Thesarit Tiranë.

Në lekë

VKM	Kodi i Projektit/ri	Artikulli buxhetor	Emertimi projektit	Vlera Kosto filestare/VKM	Vlera e kontrates	Financime deri ne 2023	Disbursime deri ne 2023	Plan buxheti viti 2024	Faktik deri ne 31.12.2024
Nr 9, datë 10.01.2020	94902AI	230000	Për caktimin e njësjë zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga Fondi për Rindërtimit.	124,877,000	50,449,282	124,877,000	43,031,401	81,845,599	
Nr.10, datë 10.01.2020	94902AJ	602000	Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Bashkinë Tiranë dhe për ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.	200,000,000	198,446,354	200,000,000	156,824,632	43,175,368	
Nr.212 date 11.03.2020/VKM 688 date 06.12.2023/Nr.356 date 05.06.2024	94902AD	231000	Fondi për rindërtim për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore	5,184,188,593	5,062,534,569	5,030,293,716	4,850,878,423	207,884,152	190,626,271
Nr.631 date 29.07.2020/Nr.204 date 25.03.2021/VKM 612 date 20.10.2021/VKM 774 date 15.12.2021	94902AD	231000	Rindërtimi i objekteve arsimore (ndryshim i VKM 212) - Mobiliteti	927,542,378	900,426,923	927,542,378	830,668,623	96,873,755	68,608,280
Nr. 1134 date 24.12.2020/Nr.767 dt 12.12.2022/VKM 689 date 06.12.2023	94902AD	231000	Rikonstruksion objekte arsimore (RSU nr.1 (nr 15- 18-19)nr. 20-21; nr 22-23"ne RSU nr.1 shkolla "Dritas"	1,608,555,182	1,550,546,426	1,258,740,100	1,228,711,112	30,028,988	19,029,265
Nr. 374, date 06.05.2020/VKM Nr. 590 date 13.10.2021	94902AC	231000	Për disa ndryshime ne VKM nr. 202 "Për përdorimin e fondit te rindërtimit miratuar ne buxhetin e vitit 2020, per financimin e rindërtimit te banesave individuale"	2,140,724,451	2,133,979,036	2,140,724,451	1,803,214,078	337,510,350	907,974
Nr. 375, date 06.05.2020 /Nr. 761 date 23.09.2020/ Nr.128 date 03.03.2021/Nr.425 dt 08.07.2021/VKM 591 date 13.10.2021/VKM 802 date 12.12.2022/VKM 683 date 06.12.2023/VKM 340 date 05.06.2024	94902AE	231000	"Për disa ndryshime në Vendimin nr.307, datë 16.04.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike, në funksion të rindërtimit të banesave individuale dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"	8,409,984,432	3,443,576,847	1,764,732,318	1,645,376,096	282,141,581	140,705,724
Nr.540 date 08.07.2020/VKM 715 date 24.11.2021	94902AB	602000	Rikonstruksion ose riparim i njediseve në bashkëpronësi	383,850,000	374,185,601	374,184,343	374,181,630	2,713	
Nr.645 date 03.08.2020/Nr.202 dt 25.03.2021/Nr.424 dt 08.07.2021/VKM 773 date 15.12.2021/vkm 787 date 12.12.2022/VKM 673 date 06.12.2023/VKM 366 date 05.06.2024	94902AC	231000	Rindërtim për financimin e rindërtimit të njësjë të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji" dhe njësinë administrative 6, zona "Kombinat	14,385,346,958	13,803,441,414	9,356,699,756	8,634,033,409	3,153,597,013	2,149,318,506
Nr.650 date 13.08.2020	94902AI	602000	Hartim projekti te nderlyrjeve rehabilituese	87,358,750	75,419,100	87,358,750	73,255,781	14,102,969	
Nr. 918 date 11.11.2020	94902AG	231000	Shpronësim,Zhvillimi i Njesise Administrative Vaqarr	47,368,594	46,218,271	47,368,594	40,642,162	1,150,323	
Nr.27 date 20.01.2021/VKM 672 date 06.12.2023/Nr.772 date 12.12.2022	94902AB	231000	Riforcim i njësjë të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë	840,575,731	779,434,067	774,161,721	573,751,906	200,409,814	65,860,614
Nr.62 date 03.02.2021	94902AG	231000	Shpronësim per zhvillimin e njesive pas termetit ne NJA Zall Herr	6,721,869	6,721,869	6,721,869	5,576,109	6,721,869	
Nr.129 date 03.03.2021	94902AH	602000	Per shembjen e njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) te pabanueshme te demtuara nga termeti i dates 26.12.2019	317,313,375	102,116,263	317,313,375	54,364,976	262,948,399	
Nr.181 date 30.03.2022/Nr. 359 date 05.06.2024	94902AB	231000	Riforcim i njësjë të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë	1,166,365,230	688,639,315	233,273,046	33,496,000	911,756,516	53,117,600
Nr.445 date 29.06.2022	94902AD	231000	Rindërtim I Objekteve Arsimore	303,102,373	303,102,373	303,102,373	302,598,113	504,260	
Nr. 540 date 08.07.2020/Nr.24 date 20.01.2021/Nr.121 date 02.03.2022	94902AB	606000	Rikonstruksion i njësjë individuale të banimit dhe njësjë të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë/DS1 DS3	1,910,370,000	1,910,370,000	1,910,370,000	1,910,370,000	-	
Nr./52 date 16.09.2020/ Nr.21 date 20.01.2021/Nr.782 date 12.12.2022	94902AB	606000	Rikonstruksion/riparim i njësjë individuale të banimit/njësjë të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Tiranë- Ds4	540,825,352	540,825,352	206,061,269	205,145,815	915,454	
Nr. 540 date 08.07.2020/ Nr.23 date 20.01.2021/Nr.781 date 12.12.2022	94902AC	606000	Rindërtim i banesave individuale në Bashkinë Tiranë- Ds5	1,209,040,322	1,209,040,322	1,209,040,322	1,205,538,690	1,407,586	
			TOTALI	39,794,110,590	33,179,473,384	26,272,565,381	23,971,658,956	5,632,976,709	2,688,174,234

4.10 Tabela e raportit të financimeve të huaja.

Në tabelën më poshtë paraqitet informacion mbi financimet e huaja që bazuar në udhëzimin Nr.10 datë 12.07.2024 “ Për regjistrimin, rakordimin,raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” janë projekte jo me skemë thesari pra veprimet bëhet në bankat e nivelit të dytë monitoruar nga Ministria e Financave. Këto projekte kanë qenë pjesë e buxhetit duke u miratuar rast pas rasti me vendime Këshilli Bashkiak.

Në lekë

Programi	Programi Buxhetor	Kodi i Projektit	Projekt	Kosto	Plan 2024	Fakti 12-M 2024
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101010	Command and Operations Mechanism for Multisector Analysis of Nexus Disaster Data	6,879,852	164,313	164,313
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101014	Fostering Interfaith Dialogue and Enhancing Cross-border Religious Tourism	21,738,985	3,600,000	3,600,000
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101011	Cross Water Integrated Water Management System in Crossborder Area	88,002,842	5,898,654	5,898,654
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101012	Circle Project 959- Circular Innovation and Resilient City Labs in the Adriatic Region	16,600,106	1,198,701	1,198,701
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101013	Civic Energy Future: Sustainable Local Energy Communities- LEC	25,236,750	2,143	2,143
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101008	Monumenti qe zgjon turizmin-Persqop,Petrele	27,259	1,200	1,200
4740	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	G101009	Parku i Liqenit te Farkes nje Pol Rekreativ per Tiranen	1,316,230	400	400

5. Tabela e raportit të investimeve sipas programeve.

Në lekë

Emërtimi	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	% ndaj planit vjetor	struktura/ plani vjetor
01110 Planifikim, Menaxhim & Administrim	306,642,396	358,137,682	100,597,062	28%	2%
03140 Shërbimet e Policise Vendore	37,400,000	107,758,120	17,802,120	17%	1%
03280 Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	48,132,917	212,168,042	77,911,504	37%	1%
04130 Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	542,870,088	679,013,108	346,735,655	51%	5%
04220 Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	108,119,608	90,811,919	564,000	1%	1%
04240 Menaxhim I Infrastrukturës se Ujitjes & Kullimit		6,982,199	466,529	7%	0%
04520 Rrjeti Rrugor Rural	2,829,627,190	3,264,993,602	1,504,734,057	46%	23%
04570 Transporti Publik	151,494,000	219,207,557	24,402,225	11%	2%
06140 Planifikim Urban Vendor	1,225,440,359	1,243,215,422	111,939,436	9%	9%
06210 Programet e Zhvillimit	12,154,259	107,976,785	35,861,213	33%	1%
05100 Menaxhim I Mbetjeve		2,380,692		0%	0%
06260 Shërbimet Publike Vendore	3,039,431,355	2,915,713,154	1,171,342,416	40%	20%
08130 Sport dhe Argëtim	25,100,000	170,000	168,000	99%	0%
08220 Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	227,558,572	162,505,907	25,203,768	16%	1%
08230 Arti dhe Kultura				0%	0%
09120 Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor	1,006,725,562	1,317,808,615	620,986,489	47%	9%
09230 Arsimit mesëm I përgjithshëm	782,525,384	893,448,288	577,861,572	65%	6%
09450 Arsimit Universitar				0%	0%
10430 Përkujdesje Sociale	9,227,820	10,577,140	5,014,423	47%	0%
10661 Strehimi Social	2,730,278,660	2,862,608,942	132,312,470	5%	20%
10910 Emergjencja Civile				0%	0%
TOTAL	13,082,728,170	14,455,477,174	4,753,902,939	36%	100%

Vlerat e investimeve në tabelën e mësipërme nuk përfshijnë Donatorët, Transferten e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin, Financimet e Huaja,Transferten e Kushtëzua.

Raportimi i detajuar i investimeve paraqitet në aneksin nr 5 bashkëlidhur raportit.

5.1 Përdorimi i fondit rezervë dhe fondit të kontigjencës

Fondi Rezervë për periudhën Janar –Dhjetor 2024, është përdorur si më poshtë:

- VKB Nr. 36, datë 28.03.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125, datë 22.12.2023, të këshillit bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, shtuar me shumën 1,000,000,000, lekë.
- VKB nr.47, datë 30.04.2024 “Për shpërblim financiar të Klubit të Futbollit “Partizani” sh.a, si rezultat i fitimit të vendit të parë, në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore, për sezonin 2022-2023”, pakësuar në shumën 15,000,000 lekë.
- VKB Nr. 69 datë 27.06.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”, pakësuar me 294,935,749 lekë.
- VKB Nr. 57 datë 27.06.2024 “Për mbështetjen e studentëve shqipëtarë që janë pranuar për të studiuar pranë Kolegjit të Europës në Tiranë”, pakësuar në shumën 8,200,000 lekë.
- VKB Nr. 77, datë 22.07.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.125 dt 22.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e PBA 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të BT për vitin 2024” të ndryshuar, pakësuar me shumën 33,815,000 lekë.
- VKB nr.76 dt 22.07.2024 “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “TEDA Tiranë” shpk, si person juridik në pronësi të BT”, pakësuar në shumën 20,000,000 lekë.

Nga Fondi i Kontigjencës përgjatë vitit 2024 nuk ka pasur përdorim fondi.

KAPITULLI III MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim

Ky program përfshin:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

Qëllimi i programit - Të zhvillojë dhe zbatojë politikat e përgjithshme për personelin; Shërbime të përgjithshme publike. Të merret me administrim, funksionim dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit; Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale;

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024, krahasuar me planin e vitit, është në masën 78%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 86%
- Shpenzime të tjera operative 73%
- Shpenzime kapitale 45%


Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	2,729,587,510	2,729,587,510	2,360,769,735	86%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	1,580,958,988	2,154,470,993	1,577,965,780	73%
<i>Shpenzime kapitale</i>	306,642,396	470,991,476	211,884,715	45%
Totali	4,617,188,894	5,355,049,979	4,150,620,230	78%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Planifikim, Menaxhim & Administrim



Objektivi I i këtij programi është: Rritja e kapaciteteve të vazhdueshme të stafit. Përmirësimi, motivimi dhe angazhimi i punonjësve të administratës. Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë së Tiranës dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:
 Produkti 1: ” Rritja e kapaciteteve TIK të infrastrukturës qendrore (datacenter) dhe rritja e kapaciteteve për përdoruesit fundorë” për 12-mujorin 2024 është planifikuar 1,814,880 lekë dhe është realizuar 100% e planit 12-mujor.

Produkti 2: ”Ri-optimizimi dhe Standartizimi i proceseve të punës së strukturës së institucionit të Bashkisë Tiranë” për 12-mujorin 2024 është planifikuar 15,890,000 lekë, dhe është realizuar në vlerën 13,390,000 lekë. Nëpërmjet këtij produkti kërkohet të maksimizohet struktura me të cilën funksionon institucioni i Bashkisë Tiranë dhe në të njëjtën kohë të trajnohen stafet që i përdorin këto procese, të rritet efienca organizative duke i përmirësuar këto procese nëpërmjet eliminimit të proceseve që zgjasin shërbimet në kohë, mirëpërcaktimin e mbarëvajtjes së punës, përmirësimin e komunikimit ndërmjet drejtorive dhe parashikimin e ndryshimeve. Në të njëjtën kohë synohet të arrihet përafrimi me Standartet e Bashkimit Europian dhe përcaktimin e të gjitha elementeve ligjore që mund të kenë nevojë për përmirësim.

Objektivi II i këtij programi është: Rritja e transparencës dhe imazhit të Bashkisë Tiranë kundrejt përthithjes së kandidatëve për t’u rekrutuar si nëpunës civilë dhe praktikantëve për të siguruar një edukim sa më të mirë të qytetarëve me tregun e punës dhe përfitimin e krahëve shtesë të forcës punëtore në Bashki në mënyrë eficiente. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Fillo me një ide, fito një praktikë pune në Bashkinë Tiranë” për 12-mujorin 2024 është planifikuar 2,800,000 lekë dhe ka patur realizim në vlerën 2,402,900 për 12 mujorin dhe është realizuar në 86% të planit.

Produkti 2: Panairi i Punës për 12-mujorin 2024 është planifikuar 1,500,000 lekë dhe ka patur realizim në vlerën 1,347,880 për 12 mujorin dhe është realizuar në 90% të planit.

Objektivi III i këtij programi është: “Shërbime të përgjthshme publike, administrim, funksionim dhe ofrim i shërbimeve të mbështetjes për aparatit e Bashkisë Tiranë”. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucionet e tjera të Bashkisë Tiranë”, është planifikuar 183,585,600 lekë dhe është realizuar 82% e planit 12 mujor.

Objektivi IV i këtij programi është: “Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likujdojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit.” Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024 është realizuar produkti me të dhëna si më poshtë:

Produkti 1: Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit, për 107,317 tatim pagues aktivë, janë shpenzuar 37,253,909 lekë nga 41,603,000 lekë të planifikuar për vitin 2024.

Investime për programin Planifikim, Menaxhim & Administrim për vitin 2024 janë :

- “Ndertim i godins “Godina nr.22, Blv Zogu 1” (7-katshi), plani për këtë projekt është në vlerën 106,624,029 lekë dhe ka patuar një realizim 100% për 12-mujorin 2024.

Funksioni 2 : RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi – 03140: Sherbimet policise vendore

Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë

Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është: Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe këshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 80%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 100%
- Shpenzime të tjera operative 21%
- Shpenzime kapitale 17%


Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	666,114,000	696,114,000	695,582,306	100%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	58,531,000	118,531,000	24,557,001	21%
<i>Shpenzime kapitale</i>	37,400,000	107,758,120	17,802,120	17%
Totali	762,045,000	922,403,120	737,941,427	80%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfaqësojnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Shërbimet e Policisë Vendore



Për 12-mujorin 2024 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Investimet për programin Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2024 janë 3 projekte / investime që menaxhohen nga Institucioni që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 17,818,120 lekë për 12-mujorin 2024 dhe patur realizim në masen 100% për 12-mujorin e vitit 2024.

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. MZSH
3. Emergjenca Civile

Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është: Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 54%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 76% |
| - Shpenzime të tjera operative | 53% |
| - Shpenzime kapitale | 32% |

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	185,004,000	241,768,138	184,240,794	76%
Shpenzime të tjera operative	88,222,000	872,110,106	465,256,273	53%
Shpenzime kapitale	75,160,375	239,750,500	77,911,504	32%
Totali	348,386,375	1,353,628,744	727,408,571	54%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin,

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 12-mujorin 2024 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Investimet për programin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2024 përbëhet nga 18 projekte/investime me një realizim prej 76,417,344 lekë ku peshën më të madhe e zënë investime për Emergjencat Civile me një realizim prej 33% mbi planin. Investimet për Emergjencat Civile përbëhen nga investime në vazhdim nga vitet e mëparëshme dhe investime të reja me një realizim prej 86% mbi planin e vitit 2024 ku investimet kryesore janë si më poshtë:

- Mur mbajtes ne rrugen e fshatit Vesqi - njesia Administrative Baldushk, për të cilën janë planifikuar 15,614,523 lekë, dhe ka patur një realizim në vlerën 13,030,589 lekë ose 83% e planit për 12-mujorin 2024.
- Ndërhyrje emergjente për shkarkimet e K.U.Z. dhe K.U.SH. për godinat e rindërtimit në pjesën përfundimtare të zonës zhvillimore Kombinat për të cilën janë planifikuar 5,624,718 lekë, dhe është realizuar 81% e planit.
- Rehabilitimi I Emergjencës Civile, Muri Mbajtës rruga Fair Hadushaj për të cilën janë planifikuar 26,603,578 lekë, dhe është realizuar 79% e planit.

FUNKSIONI 3: ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbeshtetje per zhvillim ekonomik

Në këtë program bën pjesë:

1. Aparati i Bashkisë
2. Agjencia e Administrimit të Tregjeve

Qëllim i programit te programit :

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbeshtetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 56%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 100%
- Shpenzime të tjera operative 57%
- Shpenzime kapitale 53%


Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	52,640,000	53,340,000	53,112,861	100%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	137,360,974	195,353,858	110,933,492	57%
<i>Shpenzime kapitale</i>	558,159,268	710,595,880	373,350,634	53%
Totali	748,160,242	959,289,738	537,396,987	56%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, TVSH Detyrime, Transferten e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale, Financimet e Huaja.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Mbështetja për Zhvillim Ekonomik



Për 12-mujorin 2024 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 959,289,738 lekë për 12-mujorin 2024.

Objektivi I i këtij programi është: Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja të gjelbërta të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur element go-green në to” për 12-mujorin 2024 është planifikuar 18,000,000 lekë dhe është realizuar 86% e planit.

Produkti 2: Projekti "Gjithëpërfshirje shoqërore dhe fuqizim ekonomik në Ballkanin Perëndimor" për 12-mujorin 2024 është planifikuar 2,685,750 lekë dhe është realizuar 93% e planit.

Objektivi II i këtij programi është: Projekte që kanë për qëllim promovimin e turizmit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Turizmi për 12-mujorin 2024 është planifikuar 61,400,000 lekë dhe është realizuar 67% e planit 12 mujor.

Produkti 2: Investim i nisur gjatë vitit 2022 është Ndërtimi i infrastrukturës publike brenda zonës “TEDA”, Tiranë për të cilën janë planifikuar 298,536,664 lekë dhe është realizuar 288,075,425 lekë ose 96% e planit 12-mujor 2024.

Produkti 3: Investim “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulture)” për të cilën janë planifikuar 76,220,890 lekë dhe është realizuar në masën 49% e planit 12-mujor 2024.

Programi - 04220: Sherbimet bujqesore,inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Në këtë program bëjnë pjesë:

1. Aparati i Bashkisë
2. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit është:

Të hartojë, zbatojë dhe monitorojë politika të përgjithshme ekonomike në lidhje me zhvillimin rural. Funkzionimin ose mbështetjen e politikave vendore të zhvillimit ekonomik, krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural dhe tregtar brenda njësisë si edhe të hartojë projekte të ndryshme në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit. Kontrolli ushqimor dhe mbrojtje te konsumatorit

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 60%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 91%
- Shpenzime të tjera operative 46%
- Shpenzime kapitale 1%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	218,481,000	218,481,000	199,257,636	91%
Shpenzime të tjera operative	103,176,058	101,076,058	46,642,357	46%
Shpenzime kapitale	108,119,608	90,811,919	564,000	1%
Totali	429,776,666	410,368,977	246,463,993	60%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 12-mujorin 2024 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Objektivi I i këtij programi është: Iniciativë për të nxitur prezantimin dhe promovimin e produkteve lokale dhe rurale. Për arritjen e këtij objektivi për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: TiranAgro është projekti i cili do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të panairit vjetor, ku do të promovohen produktet bujqësore dhe blegtorale si: vreshtaria, bulmeti, mjalti, frutat e egra, bimët medicinale, etj., si dhe artizanët dhe prodhimet e tyre. Ky projekt do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë Administrative Rurale, Drejtori të ndryshme të Bashkisë Tiranë, si dhe shoqatat të cilat operojnë në fushën e artizanatit. Për arritjen e këtij objektivi, për vitin 2024 ky projekt është planifikuar në vlerën 7,312,158 lekë dhe është realizuar në masën 100% e planit 12-mujor 2024.

Objektivi II i këtij programi është: Hartimi i planeve të reja të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkisë Tiranë për të evidentuar gjendjen aktuale të fondit pyjor e kullësor, plane të cilat parashikojnë masat që duhen të ndërmerren në 10-vjeçarin e ardhshëm. Për arritjen e këtij objektivi për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon

Produkti 1: Hartimi I planit të mbarështimit të ekonomise pyjore "Zall-Herr -Priske" dhe Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomise pyjore "Vërrit dhe Vore". Këto projekte synojnë të përmirësojnë menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor nëpërmjet vendosjes së rregullave të qarta për shfrytëzimin dhe përdorimin racional të pyjeve dhe kullotave.

Për arritjen e këtij objektivi, për vitin 2024 janë planifikuar 9,528,900 lekë dhe është realizuar në masën 50% e planit 12-mujor 2024.

Programi -04240: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Ky program përfshin institucionet:

1. Aparatin e Bashkisë Tiranë
2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Qëllimi i programit është:

Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 37%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzime personeli 0%
- Shpenzime të tjera operative 99%
- Shpenzime kapitale 1%
-

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli		240,000		0%
Shpenzime të tjera operative	23,851,233	24,141,902	23,941,902	99%
Shpenzime kapitale		42,311,492	466,529	1%
Totali	23,851,233	66,693,394	24,408,431	37%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta dhe Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Përmirësimi i gjëndjes në kanalin ujitës

Produkti 1 : “Rikonstruksion në kanalin ujitës KU Arbanë” për të cilën plani i vitit 2024 është 6,982,199 lekë dhe është realizuar në masën 7% e planit 12-mujor 2024.

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Ky program përfshin institucionet:

1. Agjencia e Parqeve & Rekreacionit (pyjet)

Qëllimi i programit është:

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore si dhe administrim i fondit pyjor dhe kullor publik. Ky program menaxhohet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 91%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzime personeli 0%
- Shpenzime të tjera operative 95%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	500,000	500,000	-	0%
Shpenzime të tjera operative	11,794,754	12,089,994	11,472,000	95%
Totali	12,294,754	12,589,994	11,472,000	91%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Ky program përfshin institucionet:

1. Aparati i Bashkise
2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Qëllimi i programit është:

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses të plotë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 67%.


Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 99%
- Shpenzime të tjera operative 92%
- Shpenzime kapitale 52%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	510,733,000	527,783,000	523,271,207	99%
Shpenzime të tjera operative	599,530,099	1,560,127,939	1,434,884,182	92%
Shpenzime kapitale	3,607,955,104	3,849,982,631	2,016,830,959	52%
Totali	4,718,218,203	5,937,893,570	3,974,986,348	67%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatoret, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti i këtij programi është: Rehabilitimi dhe sistemim asfaltimi i rrugëve të qytetit të Tiranës, ku përcaktohen dëmtimet në rrugë, trotuara dhe bordura, në bazë të inventarizimit të rrugëve dhe verifikimit në terren të tyre. Mirëmbajtja e rrugëve kryesore dhe jokryesore, rrugë të sistemit parësor, dytësor dhe tretësor me shtresa asfalti, mirëmbajtjen e trotuarëve me pllaka, bordura, mirëmbajtjen dhe pastrimin e zgarave të shiut dhe kanaleve të ujërave të bardha, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e pusetave në rrugë. Fuqizimi dhe modernizimi i ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e rrjetit semaforik dhe sinjalistikës rrugore janë prioritetet e drejtorisë. Zgjerimi i mbulimit të territorit të qytetit me transport publik. Ndërtimi i terminaleve të transportit multifunksionalë. Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal.

Produkti 1: Janë realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik 17,266 m² mirëmbajtje në sheshe publike me ndriçim, 362 m² rrjet rrugor i pajisur me ndriçim publik, 4,683 copë kangjella, birila ,grerëza për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale, 3,338 copë tabela për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, 18,770 m² vijëzime rrugësh me bojë, 139 cope mirëmbajtje nyje semaforike, 87,964 m² rrugë të shtruara me asfalt, 18,152 m² mirëmbajtje trotuare me pllaka, 2,618 m² mirëmbajtje trotuare me bordura, 2,187 cope mirëmbajtje zgara dhe puseta, 83.6 km rrugë ruale të mirëmbajtura, 58.8 m² mirembajtje e urave, 4,195 ha siperfaqe bujqesore e mbuluar me ujitje, 2,195 ha siperfaqe bujqesore e mbuluar me kullim.

Produkti 2: Studim projektim "Rehabilitim i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rruga "Jusuf Gërvalla" – "Hamit Keci" dhe "Kastriotet"". Për arritjen e këtij objekti, për vitin 2024 janë planifikuar 3,083,554 lekë dhe është realizuar 1,377,274 lekë ose 45% e planit 12-mujor 2024.

Produkti 3: Rikonstruksioni i rrugës “At Stath Melani”, plani i planifikuar për këtë produkt është 58,805,465 lekë, për këtë periudhë është realizuar 12-mujorin 53,648,412 lekë ose 91% e planit 12-mujor 2023.

Produkti 4 : Rikonstruksioni i rrugës "Grigor Cilka", plani i planifikuar për këtë produkt është 79,315,363 lekë, për këtë periudhë është realizuar 12-mujorin 100% e planit 12-mujor 2024.

Produkti 5 : Ndërtimi i rrugës Shëngjin deri në fshatin Shën Meri ”, plani i planifikuar për këtë produkt është 78,627,313 lekë, për këtë periudhë është realizuar 12-mujorin 78,627,080 lekë ose 100% e planit 12-mujor 2024.

Produkti 6: Ndërtimi i Terminalit Verior të Transportit Publik, Tiranë, plani i planifikuar për këtë produkt është 234,382,855 lekë, për këtë periudhë është realizuar 12-mujorin 100% e planit 12-mujor 2024.

Produkti 7: Ndërtimi i infrastrukturës lidhëse me autostradën Tiranë–Elbasan, plani i planifikuar për këtë produkt është 135,000,000 lekë, për këtë periudhë është realizuar 12-mujorin 100% e planit 12-mujor 2024.

Programi - 04570: Transporti publik

Ky program përfshin institucionet:

1. Aparati i Bashkisë
2. Tirana Parking

Qëllimi i programit është:

Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimin rrugor të trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore; Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore; Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal;

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 56%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 92%
- Shpenzime të tjera operative 72%
- Shpenzime kapitale 8%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	172,796,000	172,796,000	158,337,835	92%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	478,418,040	541,418,040	388,133,157	72%
<i>Shpenzime kapitale</i>	235,494,000	303,207,557	24,402,225	8%
Totali	886,708,040	1,017,421,597	570,873,217	56%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushhtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Projekte të ndryshme që sigurojnë mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 2: Subvencion për shërbimin e transportit publik qytetës në Bashkinë e Tiranës. Për arritjen e këtij objektivi, për vitin 2024 ky projekt është planifikuar në vlerën 288,100,000 lekë dhe është realizuar në masën 90% e planit 12-mujor 2024.

Objektivi II i këtij programi është: Shtimi i blloqeve rezident në qytetin e Tiranës me qëllim rritjen e kapaciteteve të parkimit të qytetarëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Pajisje me sinjalistike i blloqeve të parkimit për rezident. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 5,356,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 91% të vlerës ose në vlerën 4,885,436 lekë.

FUNKSIONI 4: MBROJTJA E MJEDISIT

Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Qëllimi i programit është :

Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; Pastrimi i rrugëve, parqeve etj; Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja; Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të

ndotjes, si dhe masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes; Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin e ndotjes; Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit; Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore; Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor; Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzime të tjera operative 83%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime të tjera operative	2,916,889,090	3,335,901,081	2,755,245,783	83%
Shpenzime kapitale		2,380,692		-
Totali	2,916,889,090	3,338,281,773	2,755,245,783	83%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake; Ndarjen e diferencuar të plehrave brenda unazës së mesme. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shpenzime për Ndërtimin e Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike. Plani i planifikuar është në vlerën 1,185,359,688 lekë nga të cilat janë realizuar 931,362,638 lekë ose 79% e vlerës së planit.

Objektivi II i këtij programi është: Rikonceptimin, strukturimin, përmirësimin e frekuencës së pastrimit të zonave dhe shërbimeve të pastrimit të qytetit në Bashkinë e Tiranës së re Administrative në zonat urbane dhe rurale. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2023, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Pastrimi i Qytetit. Plani i planifikuar është në vlerën 2,023,035,742 lekë nga të cilat janë realizuar 1,791,357,476 lekë ose 89% e vlerës së planit.

FUNKSIONI 5: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Ky program menaxhohet nga:

1. Aparati i Bashkisë
2. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Qëllimi i programit është :

Zhvillimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të zhvillimit urbanistik; Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; Lëshimin e lejeve për ndërtime të reja; zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Administrim, bashkërendim dhe monitorimin e planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin; Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; Sigurimi i trullit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësisve banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; Planifikimin e përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit; Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit; Hartim, administrim, bashkërendim dhe monitorim i politikave të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve që lidhen me shërbimet për komunitetin; Planifikimi i komuniteteve të reja ose i komuniteteve të rehabilituara. Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 22%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 95%
- Shpenzime të tjera operative 51%
- Shpenzime kapitale 7%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	219,032,000	222,332,000	211,421,067	95%
Shpenzime të tjera operative	180,434,000	306,131,400	155,551,922	51%
Shpenzime kapitale	1,225,440,359	1,685,417,590	112,847,410	7%
Totali	1,624,906,359	2,213,880,990	479,820,399	22%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar/ Rindërtim

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti i këtij programi është: Mirëadministrimin e çdo çështjeje që lidhet me rritjen e efijencës së jetës së komunitetit në funksion të gjithëpërfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Fondi i Komuniteteve, për të cilin është planifikuar plani në vlerën prej 200,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 92,369,789 lekë ose 46% e planit 12-mujor. Bazuar në VKB Nr.39 datë 03.05.2019 “Për miratimin dhe zbatimin e programit “Fondi i Komuniteteve” përgjatë vitit 2024 janë kryer si më poshtë:

- 53 aplikime të shpalluar të sukseshme gjatë vitit 2024 në vlerë totale 170,849,753 lekë
- 30 kontrata dypalëshe të lidhura gjatë vitit 2024 në vlerë totale 89,220,237 lekë
- 35 likujtime të realizuar gjatë vitit 2024 në vlerë totale 92,369,789 lekë

Në këtë program buxhetor bëjnë pjesë dhe shpronësimet ku ndër të tjera mund të përmendim: Ndertimi I rruges që lidh rrugen "Don Bosko" me rrugen "Egnatia", “Rehabilitimi dhe Zgjerimi I Varrezave Tufine Faza III dhe Faza IV”, "Ndertimi I tregut për shitjen me shumicë dhe pakicë I produkteve ushqimore (Tirana Agrikulture)", Zona e re për zhvillim, Universiteti Bujqësor i Tiranës, për të cilat plani i vitit 2024 është 36,358,146 lekë dhe është realizuar 24,126,297 lekë e planit ose 66% për 12-mujorin 2024.

Programi - 06210: Programet e Zhvillimit

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 50%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime kapitale 50%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime kapitale	12,154,259	4,778,799,474	2,406,025,816	50%
Totali	12,154,259	4,778,799,474	2,406,025,816	50%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar/Rindërtim, Financimet e Huaja.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Në këtë program janë të përfshira kryesisht investime për rindërtimin në zonat e prekura nga tërmeti për vitin 2024.

Produkti 1: Hartim i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinave në zonën zhvillimore “5Maji”, plani i vitit 2024 në vlerën 1,185,954,195 lekë dhe realizimi për 972,569,298 lekë ose 45 % e planit 12-mujorin 2024.

Produkti 2: Hartim i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinave në zonën zhvillimore “Kombinat”, plani i vitit 2024 në vlerën 1,967,642,818 lekë dhe realizimi për 1,176,749,208 lekë ose 60% e planit 12-mujorin 2024.

Programi - 06260: Shërbimet Publike vendore

Në këtë program bëjnë pjesë:

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
- Agjencia e Shërbimeve Funerale

Qëllimi i Programit është:

Planifikim, përmirësimi dhe zhvillimi i strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapësirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore; administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike. Zhvillimi, rregullimi dhe përmirësimi i standardeve të ndriçimit rrugor.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 56%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime personeli 91%
- Shpenzime të tjera operative 73%
- Shpenzime kapitale 40%


Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,040,418,000	1,052,618,000	958,007,129	91%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	858,674,000	984,942,827	715,290,330	73%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,080,817,079	3,160,202,060	1,259,717,994	40%
Totali	4,979,909,079	5,197,762,887	2,933,015,453	56%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, TVSH Detyrime, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimi.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve në programin Shërbimet Publike Vendore



Objektivi I i këtij programi është: Rikualifikimi i hapësirave publike, rehabilitim i sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese, shtim i ambjenteve shplohëse dhe argëtuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Ndërtim i infrastrukturës publike në zonën e Baldushkut vlera e planifikuar për vitin 2024 është 8,763,589 lekë dhe realizimi është 8,490,683 lekë ose 97% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 2: Ndërtim pedonale, pistë vrapimi dhe kors biciklete ne liqenin e Farkes vlera e planifikuar është 31,431,927 lekë dhe është realizuar në vleren 31,332,903 lekë ose 100% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 3: Rikonstruksioni i bllokut dhe degëzimeve per rrugët: "Nikoll Mekjashi"- "Shyqyri Basha"- "Kostandin Shpataraku"- "Minella Karajani" - "Bajazit Shehu", vlera e planifikuar është 47,572,133 lekë dhe është realizuar në vleren 20,008,754 lekë ose 42% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 4: Rikualifikim i bllokut qe kufizohet nga rrugët "Liman Kaba", Prokop Mima", "Robert Shvarc" dhe "Skender Luarasi", vlera e planifikuar është 49,967,361 lekë dhe është realizuar në vleren 29,555,087 lekë ose 59% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 5: Rikualifikim bllokut që kufizohet nga Teodor keko, Tom Plezha, Mikel Maruli dhe Loni Ligori, vlera e planifikuar është 104,859,103 lekë dhe është realizuar në vleren 95,250,913 lekë ose 91% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 6: Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga Rr. "Mine Peza" - "Fortuzi" - Zogu I" - "Haxhi Hysen Dalliu" - "Asim Vokshi", vlera e planifikuar është 94,357,900 lekë dhe është realizuar në vleren 92,830,002 lekë ose 98% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 8: Rikualifikim urban i zonës "Kodra e Diellit"- Faza I dhe Faza II, vlera e planifikuar është 210,110,479 lekë dhe është realizuar në vleren 170,992,707 lekë ose 81% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 7: Rehabilitimi i sheshit përpa degës së Thesarit Tiranë, Rruga "Mustafa Lleshi" vlera e planifikuar është 6,697,640 lekë dhe është realizuar në vleren 5,761,969 lekë ose 86% e planit për 12-mujorin 2024.

Produkti 8: Rikualifikimi urban i zonës informale që kufizohet nga rrugët Sabaudin Gabrani - Jonuz Rama - Hamdi Çullhaj - Damian Himarioti - Bari Ishka- Vasfi Samini -Alush Elmaz Taka vlera e planifikuar është 45,792,184 lekë dhe është realizuar në vleren 35,940,606 lekë ose 78% e planit për 12-mujorin 2024.

Objektivi II i këtij programi është: Administrimi dhe organizimi i shërbimeve funerale, pastrimi mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave publike. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe për mirëmbajtjen totale të varrezave në total janë 502,070 m², sipërfaqe të cilat duhen të mirëmbahen gjatë viti 2024, buxheti i planifikuar për këtë produkt për vitin 2024 është 78,717,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 34% ose 26,889,184 lekë.

FUNKSIONI 6: SHËRBIMET REKREATIVE DHE SPORTIVE

Programi - 08130: Sport dhe argetim

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Agjencia e Rinisë dhe Mireqenies Sociale
- Klubi Sportiv “Tirana”
- Klubi shumësportësh “Partizani”
- Klubi Sportiv “Studenti”

Qëllimi i Programit është :

Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipe apo lojtarë ndividualë;Vënie në funksionim ose mbështetje për ambiente që përdoren për veprimtari çlodhëse (parqe, plazhe, kampingje dhe vendqëndrimet përkatëse) të ofruara në bazë jotregtare.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 92%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 88%
- Shpenzime të tjera operative 92%
- Shpenzime kapitale 99%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	102,276,000	106,300,094	93,273,286	88%
Shpenzime të tjera operative	423,954,000	638,125,573	589,991,284	92%
Shpenzime kapitale	25,100,000	170,000	168,000	99%
Totali	551,330,000	744,595,667	683,432,570	92%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfaqësojnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Ky program është në funksion të krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave sportive dhe organizimit të aktiviteteve për rininë.

Përgjatë vitit 2024, më Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 108 datë 08.10.2024 u miratua riorganizimi i muzeut vendor “Shtëpia Studio Kadare Agolli” duke bashkuar në një të vetëm të dy institucionet e varësisë për të vijuar më tej si një institucion me ekspozimin, njohjen dhe promovimin e veprës së shkrimtarëve të shquar shqiptarë Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 115 datë 08.10.2024 u miratua transformimi i Klubit Sportiv “Tirana” në organizatë jofitimprurëse dhe miratimin e akteve të themelimit të saj në zbatim të ligjit nr.79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar.

Për 12-mujorin 2024 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

Objektivi I i këtij programi është: Mbështetje për projekte të ndryshme sportive. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Sportive. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 151,782,000 lekë i cili është realizuar në masën 100% të planit 12-mujor.

Objektivi II i këtij programi është: Mbështetje për projektet rinore që do të organizohen në Tiranë dhe rrethina në bashkëpunim edhe me shoqata të ndryshme. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Rinore. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 77,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 67,300,000 lekë ose 87% të planit 12-mujor.

Objektivi III i këtij programi është: Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve, për të mbështetur mirëqënien dhe zhvillimin e të rinjve, zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore; bashkëpunimin me organizatat vendase dhe të huaja; nxitjen, vlerësimin dhe promovimin e aftësive të studentëve në fusha të ndryshme shoqërore si arti, kultura, edukimi, sporti, objektivi i cili menaxhohet nga Agjencia e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Biletë e pajtimit mujor të përgjithshëm (Abone Studenti) për studentët e pajisur me kartë student për të gjitha linjat në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 124,200,000 lekë nga të cilat është realizuar 105,219,600 lekë ose 85% e planit 12-mujor.

Programi - 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe insitucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Rinore TEN
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare-Agolli"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tiranë
- Galeria e Artit Tirana
- Agjensia e Industrisë Kreative
- Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik

Qëllimi i Programit është:

Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore , administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike; Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e të ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytetar; Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave; Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokale. Rritjen e cilësisë së praktikave kulturore të qytetarit të Tiranës nëpërmjet ofrimit të projekteve artistike e kulturore inovative me një cilësi të lartë e bashkëkohore.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 83%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 91%
- Shpenzime të tjera operative 90%
- Shpenzime kapitale 16%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	218,683,000	223,412,000	202,496,849	91%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	536,370,000	1,207,653,492	1,088,649,205	90%
<i>Shpenzime kapitale</i>	227,558,572	162,506,364	25,203,768	16%
Totali	982,611,572	1,593,571,856	1,316,349,822	83%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Mbikqyrja dhe rregullimi i strukturave kulturore. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:
Produkti 1: Ndërtimi i shtigjeve në disa objekte historike kulturore, synon nxitjen e ecjes në natyrë dhe zhvillimin e turizmit historik e kulturor.

Objektivi II i këtij programi është: Rivitalizimi i objekteve historike e kulturore me forma të ndryshme të kreativitetit si shprehje e identitetit të kryeqytetit; Të ofrojë sa më shumë aktivitete, të cilat lidhen me programin e kulturës dhe të artit, për t'i paraqitur në Këshillin Artistiko-Kulturor, të ardhura pranë Bashkisë Tiranë, duke parë mundësitë më të mira për shtimin e impaktit. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekte Kulturore, Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 743,826,775 lekë nga të cilat është realizuar 702,704,855 lekë ose 94% e planit 12-mujor.

FUNKSIONI 7: ARSIMI

Programi - 09120: Arsimi baze perfshire arsimi parashkollor

Në këtë program bëjnë pjesë

- Aparati i Bashkisë,
- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.

Qëllimi i Programit është:

Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës; Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve; Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve; Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 71%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 79%
- Shpenzime të tjera operative 75%
- Shpenzime kapitale 61%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	1,855,811,104	2,266,612,874	1,790,242,928	79%
Shpenzime të tjera operative	821,918,785	991,590,528	738,990,320	75%
Shpenzime kapitale	1,006,725,562	1,844,225,029	1,118,172,524	61%
Totali	3,684,455,451	5,102,428,431	3,647,405,772	71%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Rindërtimin, Transfertën e Kushtëzuar

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve duke ofruar për fëmijët e çerdhes kujdes edukativ, shëndetësor, psikosocial dhe ushqim, ndërsa për fëmijët e kopshteve dhe çerdheve koordinim të kujdesit shëndetësor dhe ushqim. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Stimulim i nxënësve me dhjeta. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 115,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 98,092,581 lekë.

Produkti 2: Kompesimi ushqimor në shkollat ku do të implentohet projekti " Bëjmë detyrat e shtëpisë". Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 11,670,750 lekë nga të cilat është realizuar 1,392,710 lekë.

Produkti 3: Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "Shyqyri Peza", planifikuar në vlerën 30,562,474 lekë dhe realizuar 35%.

Produkti 4: Rikonstruksion i shkollës së Mesme "Besnik Sykja" dhe ndërtim palestere, planifikuar në vlerën 22,93,617 lekë dhe realizuar në masën 100%.

Produkti 5: Ndërtimi Shkollës 9 vjecare “Ibrahim Hima” planifikuar në vlerën 28,397,429 lekë dhe realizuar në masën 80%.

Produkti 6: Në këtë program janë të buxhetuara dhe dy kontratat e lidhura për ndërtimin e PPP-ve si “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe 4 objekteve arsimore në Zonën Tirana 4", realizuar në vlerën 350,000,000 lekë sipas kushteve të kontratave ku financuese është Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Programi - 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Në këtë program bëjnë pjesë:

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike
- Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme

Qëllimi i Programit është:

Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve të arsimit profesional (vetëm konviktet); Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; Shpenzimet për paga për stafin mbështetës. Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, për fëmijët e shkollave; Mbështetje për trajnimin e mëtjeshëm të mësuesve; Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 79%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 85%
- Shpenzime të tjera operative 89%
- Shpenzime kapitale 65%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	901,217,000	1,037,183,216	876,784,115	85%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	512,608,080	731,125,358	651,105,466	89%
<i>Shpenzime kapitale</i>	782,525,384	893,448,288	577,861,572	65%
Totali	2,196,350,464	2,661,756,862	2,105,751,153	79%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfaqësojnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale, Transfertën e Kushtëzuar.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I i këtij programi është: Rritje e kapacitetit të nxënësve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në konvikte. Për arritjen e këtij objekti, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti: Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte janë 215 nxënës për këtë 12-mujor të vitit 2024 Për këtë vit janë planifikuar të akomodohen 300 nxënës, buxheti i shpenzuar është në vlerën 120,987,567 lekë nga 159,230,131 lekë të planifikuar.

Objektivi i II i këtij programi është: Mirëmbajtje e ambienteve në objektet arsimore parauniversitare; mirëmbajtjen, lyerjen, pastrimin e grafitëve të paautorizuara, shkarravinave me përmbajtje anti-kulturore, figurave, reklamave apo ngjitjeve me materiale të ndryshme në sipërfaqet e mbikalimeve, nënkalimeve përfshirë kolonat mbajtëse, muret rrethuese që përbëjnë pjesë të arkitekturës urbanistike, platformat ku janë vendosur monumente artistike, konstruksionet e shatërvaneve, si dhe çdo sipërfaqe tjetër ndërtimore e aksesit publik.

Produkti 1: Në këtë program janë të buxhetuara dhe dy kontratat e lidhura për ndërtimin e PPP-ve si “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe 4 objekteve arsimore në Zonën Tirana 4", realizuar në vlerën 372,499,316 lekë sipas kushteve të kontratave ku financuese është Bashkia e Tiranës.

Funksioni 8: MBROJTJA SOCIALE

Programi - 10430: Kujdesi social per familjet dhe femijet

Ky program menaxhohet nga :

- Aparati i Bashkisë
- Qendra Komunitare “Për persona me aftësi të kufizuar”
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”
- Qendra Komunitare “Shkozë”
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”
- Qendra Komunitare e Terrenit
- Qendra Komunitare Multidisiplinare
- Qendra Sociale “Strehëza”.

Qëllimi i Programit është:

Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 96%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 87%
- Shpenzime të tjera operative 96%
- Shpenzime kapitale 47%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
Shpenzime personeli	201,950,000	202,730,000	176,631,431	87%
Shpenzime të tjera operative	180,597,920	3,286,446,580	3,170,133,539	96%
Shpenzime kapitale	9,227,820	10,577,140	5,014,423	47%
Totali	391,775,740	3,499,753,720	3,351,779,393	96%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, Transfertën e Kushtëzuar.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi I për këtë program është: Zgjerimi dhe mundësimi i projekteve të kujdesit social me fokus shtresat dhe kategorite në nevojë me qëllim mbulimin me shërbime sociale të karaktereve të ndryshme inovative. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mbështetje Sociale në Shërbime për kategoritë në nevojë. Ky program synon të përmirësojë cilësinë e jetesës së kategorive në nevojë, përmban projekte dhe përkujdesje në realizimin e këtyre projekteve inovative me karakter social që kanë në fokus: fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi ndryshe, të moshuarit në nevojë, fuqizimin social dhe stabilitetin ekonomik të gruas kryefamiljare dhe grave në nevojë nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të përkujdesjes sociale të mundësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Bashkia Tiranë.

Objektivi II për këtë program është: Sigurimi i shërbimeve sociale kryesisht Rom, duke i mbrojtur nga të gjitha format e shfrytëzimit, duke garantuar përmbushjen e nevojave të tyre parësore dhe integrimin e tyre në shoqëri përmes ofrimit të shërbimeve multidimensionale që lidhen me arsimimin, integrimin, dhe rritjen e aksesit në shërbime. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shërbime ditore emergjence për fëmijë dhe familje në nevojë / Nisma ARSIS e cila mundëson shërbime multidisiplinare në ndihmë të fëmijëve e të rinjve në gjendje vështirë financiare.

Objektivi III për këtë program është: Ndihmë ekonomike ose shërbime të përkujdesit me Fondet e Buxhetit Vendor për familjet me shumë pjesëtarë apo familje në nevojë. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mbrojtja sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e NE. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 10,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 7,720,724 lekë ose 77% e planit 12-mujor.

Produkti 2: Mbështetje financiare të vajzave dhe grave që trajtohen me ndihmë ekonomike me produkte të kujdesit personal gjatë ciklit menstrual. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 2,484,000 lekë nga të cilat është realizuar 1,180,800 lekë ose 48% e planit 12-mujor.

Objektivi IV për këtë program është: Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Komisione për pagesa PAK/NE. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 17,207,650 lekë nga të cilat është realizuar 14,293,000 lekë ose 83% e planit 12-mujor.

Objektivi V për këtë program është: Zbatimi i Masës së Mbrojtjes të marrë nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shërbim Eksperti të Liçensuar. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 160,000 lekë nga të cilat është realizuar 100,000 lekë ose 62% e planit 12-mujor.

Objektivi VI për këtë program është: Mbështetja e të rinjve dhe të rejave në sipërmarrjet e tyre duke u dhënë mundësi punësimi. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Sipërmarrja ime për shkollën”. Pilotimi i këtij projekti është një iniciativë e Bashkisë së Tiranës për të përfshirë dhe bërë pjesë aktive rininë shkollore në proceset vendimmarrëse të planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës arsimore të shkollave të tyre. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 12,000,000 lekë i cili është realizuar në masën 100% të planit 12-mujor.

Objektivi VII për këtë program është: Fuqizimi dhe integrimi nëpërmjet shërbimeve psiko-sociale të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Objektivi VIII për këtë program është: Mbështetja e nënës së re me qëllim aftësimin për ruajtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe psikologjike, dhe mësimin e shprehive për t'u kujdesur për të porsalindurin. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Shporta e Bebes. Synimi i kësaj shporte është mbështetja në ditët e para të lindjes, me produktet e nevojshme dhe të domosdoshme për çdo nëne, e cila ka sjellë në jetë një bebe. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 34,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 24,111,000 lekë ose 68% e planit 12-mujor.

Programi - 10661: Strehimi social

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Qëllimi i Programit është:

Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; Mbeshtetje për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 19%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzime të tjera operative 73%
- Shpenzime kapitale 5%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	541,450,000	741,889,587	542,778,157	73%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,730,278,660	2,862,608,942	132,312,470	5%
Totali	3,271,728,660	3,604,498,529	675,090,627	19%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objektivi i këtij programi është: Subvencionimi i qirasë me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për strehimin.. Për arritjen e këtij objektivi, për 12-mujorin 2024, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Subvencionimi i qirasë. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 360,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 341,818,389 lekë ose 95% e planit 12-mujor.

Produkti 3: Zbatimi i projektit “unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës”, ka për qëllim strehimin e familjeve, banesa e të cilëve preket nga ky projekt, deri në sistemimin me strehim. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 15,518,555 lekë nga të cilat është realizuar 6,863,254 lekë ose 44% e planit 12-mujor.

Produkti 4: "Për trajtimin me subvencionin e qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projektit "Për zonën e re për zhvillim, në Njësitë Administrative Nr. 4 dhe Nr. 8, Zona 5 Maji". Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 26,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 22,369,000 lekë ose 86% e planit 12-mujor.

Produkti 5: "Për trajtimin me subvencionin e qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projektit "Për zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Nr. 6, Zona Kombinat". Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 32,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 31,020,000 lekë ose 97% e planit 12-mujor.

Produkti 6: Shërbime postare, me qëllim ofrimin e shërbimit të pagesës së qirasë nga Posta Shqiptare sh.a. në favor të përfituesve të qirasë për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i dates 26 Nëntor 2019. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 16,291,032 lekë nga të cilat është realizuar 6,848,592 lekë ose 40% e planit 12-mujor.

Produkti 7: Projekti "Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri Shkozë". Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 78,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 24,933,608 lekë ose 32% e planit 12-mujor.

Produkti 8: Subvencionimi i interesave të Kredisë. Ky program synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet kredive hipotekore me kushte lehtësuese. Plani i planifikuar për 12-mujorin 2024 është 32,000,000 lekë nga të cilat është realizuar 25,589,991 lekë ose 80% e planit 12-mujor.

Produkti 9: Kontributi në vlerë monetare i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale nga ndërtimet e reja e barazvlefshme me 3% të sipërfaqes funksionale ndërtimore në pronësi të investitorit/zhvilluesit për sipërfaqe ndërtimore mbi 2,000 metër katrorë, sipas referencave të njësishme ku ndodhet ndërtimi, kontribut i cili do të jepet vetëm në sipërfaqe ndërtimore, parashikuar në programin e kujdesit social në “Investime për ndërtimin e banesave sociale referuar kontributit të sektorit privat” në vlerën 2,730,278,660 lekë për vitin 2024, por pa u përdorur ende si fond.

Programi – 10910 : Emergjenca Civile

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe është fond i kushtëzuar akorduar në bazë të VKM 414/2021.

Qëllimi i Programit është:

Ky program ka për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit. Emergjenca civile synon krijimin e kushteve për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas.

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2024, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 62%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzime të tjera operative 64%
- Shpenzime kapitale 60%

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani fillestar 2024	Plani 12M 2024	Fakti 12M 2024	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	97,586,476	97,586,476	62,163,235	64%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,730,278,660	53,787,219	32,261,028	60%
Totali	2,827,865,136	151,373,695	94,424,263	62%

Vlerat në tabelën e mësipërme përfshijnë Transfertën e Kushtëzuar.

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Në mbështetje të vendimit Nr. 414, datë 08.07.2021 për “Miratimin e Programit e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Bashkisë së Tiranës i është akorduar si fond i kushtëzuar në buxhetin e vitit 2024 vlera prej 97,586,476 lekë realizuar në masën 62,163,235 lekë ose 64%. Në pasqyrën më poshtë po japim një situatë të objekteve, kontratave të lidhura si dhe realizimit të fondit për vitin 2024.

Në lekë

Kod projekti	Emertimi	vl kontrate	Financime 2022	Financime 2023	Financime 2024
91707AB	Perforcim me pilota ne objektin 6 kate ekzistues Vllaznia 4, Loti I	15,728,280		15,717,720	10,560
91707AB	Strukture mbajtese, Dajt, Tirane, Loti II	6,561,484		4,930,380	1,628,477
91707AB	Rehabilitimi I emergjences civile, muri mbajtes mbi pilota, Mjull Bathore, Loti III	13,449,023		13,423,306	24,847
91707AB	Muri mbajtes mbi pilota, Ndroq, Loti IV	8,774,743		8,754,557	19,779
91707AB	Muri mbajtes mbi pilota, Peze Helmes, Loti V	10,519,503		10,431,313	
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, muri mbajtes mbi pilota, Sauk I Ri, Loti VI	10,853,169		10,783,901	22,271
91707AG	Rehabilitimi I Emergjences Civile, muri mbajtes Rr. Sabaudin Gabrani, Loti VII	7,247,713		6,304,167	771,709
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, rikonstrukcion rrugë me mur mbajtes ne zonen e Berzhites, Loti VIII	4,584,972		4,453,680	
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, muri mbajtes mbi pilota, Selite e Vieter, Loti IX	14,965,509		14,938,716	26,793
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, muri mbajtes mbi pilota Vishaj, Loti X	9,712,668	8,541,240	1,150,465	20,831
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, rreshqitje dherash ne Mjull Bathore, Loti XI	16,387,853	9,516,480	6,835,512	27,600
91707AB	Mbrojtja Nr 1 nga gerryerjet e lumit Zhullima Baldushk, Loti XII	19,284,421		19,257,100	27,000
91707AB	Mbrojtja Nr 2 nga gerryerjet e lumit Zhullima Baldushk, Loti XIII	11,549,778		11,524,545	22,935
91707AB	Mbrojtja Nr 3 nga gerryerjet e lumit Zhullima Baldushk, Loti XIV	6,262,800		6,231,600	11,400
91707AB	Rehabilitimi I Emergjences Civile, Mbrojtja e Diges Liqeni Cekreze, Loti XV	49,224,091	29,590,150	19,590,745	43,196
91707AG	Mbrojtje nga Perroi I Zhullimes ne Kakunje, Baldushk	19,538,913			19,473,442
91707AG	Riparimi emergjent I Ures mbi lumin Tirana, prane fshatit Ferraj	9,434,278			9,434,116
91707AG	Rikonstrukcioni I Ures Mustafa Kocaj, Njesia administrative Baldushk	9,024,732			4,706,798
91707AG	Ndertim montim-Rehabilitimi I emergjences civile me beton arme "Perroi dhe rruge e Paroses", fshati Dritas, NJA Zall Herr	2,689,742			
91707AG	Ndertim montim-Rehabilitimi I Emergjences Civile, Ura e Gurres dhe muret mbajtese, fshati Qinam, NJA Zall Herr	2,708,828			2,708,828
91707AG	Per miratimin e vleresimit te riskut nga fatkeqesite e strategjite per zvogelimin e Riskut nga fatkeqesite 2023-2030 ne nivel lokal	42,198,000			21,099,000
91707AG	demshperblime zjarre te individit			22,990,849	2,083,653
TOTAL NE VAZHDIM		290,700,500	47,647,870	177,318,556	62,163,235

6. RAPORTIMI I DETYRIMEVE TE PRAPAMBETURA

Në zbatim të udhëzimit nr.26, datë 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore" dhe udhëzimit plotësues nr.2 datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", si dhe sipas anekseve, situata financiare e Bashkisë Tiranë është një situatë normale, pasi totali i detyrimeve të paraqitura sipas akteve të rakordimit që Bashkia dhe Institucionet e Varësisë kryejnë me Degën e Thesarit zë 0.43%, ndaj totalit të shpenzimeve vjetore faktike të Bashkisë Tiranë.

NëLekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	120,165,081		0.43%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	64,866,457		
4864200	Det.Prap. Sherbime	15,161,617		
4864201	D.P.Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	331,527		
4864400	Det.Prap. Investime	37,793,304		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera	1,807,486		
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	153,000		
4864901	Paga	51,690		
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	120,165,081	27,843,801,715	0.43%

Një pjesë e detyrimeve të prapambetura rezultojnë nga mungesa e akordimit të fondeve nga ministrinë e pushtetit qëndror në kuadër të programeve ose projekteve të financuara bashkërisht.

Detyrime pushteti qëndror	Llogaria ekonomike	Vlera në lekë
Ministria Arsimit dhe Sporteve	4864300	22,877,446
Ministria Arsimit dhe Sporteve	4864400	12,453,077
Ministria Arsimit dhe Sporteve	4864900	3,865,760
Ministria Brendshme	4864900	85,055,000
Fonde nga Rindertimi	4864400	1,026,956
Fonde nga Rindertimi	4864900	347,859,258

Pjesën më të madhe të këtyre detyrimeve e zënë detyrimet e lindura nga mungesa e fondeve për programin e “Grantit të Rindërtimit” për kontratat e lidhura me përfituesit familjarë të këtij programi dhe fondet e pa akorduara të Ministrisë së Brendshme në lidhje me programin “Bonusi i Bebeve”.

Plani i shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim 2025-2027

Në Lekë

Nr.	Bashkia/Këshilli i Qarkut	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Diferencë (Fakt-Plan)	Shënime
	Bashkia Tirane	120,165,081	120,165,081			0	

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Bashkisë Tiranë për vitin 2024

në lekë

Nr.	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 Dhjetor 2024	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan i rishikuar) 2024
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	26,618,979,546	46,143,790,671
1	Taksat e veta vendore	18,952,787,538	11,694,000,000
a.	Taksa mbi pasurinë	3,365,656,677	3,927,500,000
b.	Biznesi i vogel	29,428,991	0
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	14,344,356,588	6,360,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	1,213,345,282	1,406,500,000
2	Të ardhura jotatimore	6,444,033,754	5,338,000,000
a.	Tarifat e sherbimeve publike	2,780,183,323	2,614,500,000
b.	Tarifa administrative	1,376,632,887	1,432,700,000
c.	Të tjera jo tatimore	2,287,217,544	1,290,800,000
3	Taksa të ndara	1,222,158,254	1,220,000,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	399,078,435	480,000,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	569,864,137	490,000,000
c.	Renta minerare	791,737	0
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	252,423,945	250,000,000
e.	Të tjera		
4	Transferta e pakushtezuar e përgjithshme sektoriale		5,274,057,724
5	Të tjera (të ardhura dhe grant trashëgim nga viti I kaluar)		22,281,431,103
6	Donatorë		61,301,844
7	Financime të huaja		275,000,000
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	27,843,801,715	46,143,790,671
1	Shpenzime Korrente	19,832,886,923	25,278,045,517
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	7,282,437,239	8,751,254,560
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,218,568,021	1,375,300,354
d.	Shpenzime Operative	8,837,104,590	11,401,763,626
e.	Të tjera korrente	2,494,777,073	3,749,726,977
2	Shpenzime Kapitale	8,010,914,792	20,865,745,154
3	Burimet e Financimit	27,843,801,715	46,143,790,671
a.	Të ardhurat e veta vendore	20,052,299,940	33,600,094,549
b.	Transferta e pakushtezuar	5,079,893,672	6,574,417,569
c.	Transferta e Pakushtëzuar/ Rindërtim	2,690,278,733	5,632,976,709
d.	Donacione	21,329,370	61,301,844
f.	Financimi i huaj	0	275,000,000
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

7. ECURIA E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITET 2020-2024

Trendi i kryerjes së shpenzimeve të buxhetit ndër vite paraqitet si më poshtë, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 12M 2020	Fakti 12M 2021	Fakti 12M 2022	Fakti 12M 2023	Fakti 12M 2024
Shpenzime personeli	5,376,808,868	6,026,362,806	6,164,000,889	7,399,532,664	8,561,300,837
Shpenzime të tjera operative	11,779,539,238	12,405,905,815	13,192,178,196	13,494,802,601	14,604,298,954
Shpenzime kapitale	7,365,316,658	10,064,980,793	12,755,057,190	10,341,259,161	9,028,808,893
Totali	24,521,664,764	28,497,249,414	32,111,236,275	31,235,594,426	32,194,408,684

*me të gjitha burimet e financimit

Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2020 – 2024

Në lekë

Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fakti 12M 2020	Fakti 12M 2021	Fakti 12M 2022	Fakti 12M 2023	Fakti 12M 2024
Të ardhura BT	14,764,405,599	12,683,980,056	13,458,513,212	18,615,079,403	20,045,862,700
Transferata e Pakushtëzuar	3,345,123,522	3,187,912,654	4,335,766,688	4,229,246,105	5,086,330,912
Transferata e Pakushtëzuar /Rindërtimi	2,154,086,563	8,544,772,634	9,382,668,805	3,892,458,523	2,690,278,733
Transferata e Kushtëzuar	4,200,855,263	4,027,310,955	4,910,940,791	4,478,607,980	4,350,606,969
Donacione	57,143,058	50,158,495	14,038,595	17,094,273	21,329,370
Financimet e Huaja		3,114,620	-	-	
TVSH Detyrimi			9,308,185	3,108,142	
Totali	24,521,614,005	28,497,249,414	32,111,236,275	31,235,594,426	32,194,408,684

Ashtu sikundër kemi përmendur dhe në materialet pjesë përbërëse e PBA 2024-2026, parashikohet që dhe për vitin 2024 të kemi gjendje likuiditetesh të papërdorur, për t'u trashëguar në vitin 2025. Arsytet e mbartjes së fondeve janë disa ku po rendisim kryesoret:

1- Trashëgimi nga vitet e mëparshme. Që prej 2019, realizimin faktik i buxheteve, është përfshirë në një rrjedhë jo të natyrshme, që lidhet me dy ngjarje madhore, emergjenca civile, ajo e pandemisë dhe tërmetit. Të dyja këto situata kanë impaktuar buxhetin e viteve 2019, 2020 dhe 2021, nga ku ka filluar në fakt të rritet gjendja e fondeve të trashëguara që deri në këtë moment ka qenë në një trend normal (jo më shumë se 10% e buxhetit total). Nga ana tjetër parashikimi në nivele të larta na vendos përballë riskut të mosrealizimit të të ardhurave.

2- Tejkalmi në realizimin e të ardhurave: Për vitin 2024, të ardhurat e Bashkisë së Tiranë janë me tejkalm kundrejt planit të miratuar në 146 %. Duhet përmendur gjithashtu, se të gjitha vitet e fundit, janë paraqitur me tejkalm të planit të të ardhurave, i cili lidhet më së shumti me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Parashikimi i TNI me saktësi, është i vështirë, pasi lidhet me ngarkesën e aplikimeve, e cila nuk mund të parashikohet me saktësi.

3-Realizimi i ulët kryesisht për shpenzimet kapitale, ku arsyeja kryesore është rishikimi i kostove për objekte ekzistuese. Për shkak të ndryshimeve në strukturën e Bashkisë procedurat e prokurimit nuk kanë vijuar gjatë pjesës së parë të vitit 2024, por gjatë 4 mujorit të fundit të vitit 2024.